

**MINISTRI I SHTETIT
PËR DIASPORËN**

PROJEKT STRATEGJIA KOMBËTARE PËR DIASPORËN DHE PLANI I VEPRIMIT, 2021-2025

**Për rishikimin dhe miratimin e Strategjisë
dhe Planit të Veprimit 2021-2025**



**MINISTRI I SHETITIT
PËR DIASPORËN**

www.diaspora.gov.al

HYRJE

Rishikimi i Strategjisë Kombëtare të Diasporës është një proces i cili u diskutua në Samitin e Dytë të Diasporës. Dokumenti që po ju paraqesim është një reflektim i “ndryshimeve” të propozuara nga ekspertiza e Organizatës Ndërkombëtare për Migracion, IOM. Pjesa më e rëndësishme e ndryshimeve të realizuara me ekspertët e IOM është kostimi i Masave të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare.

Projekt Strategjia Kombëtare 2021-2025 nuk përfaqëson konkluzionet përfundimtare të institucioneve shtetërore. Ai është një dokument i hapur i cili do të kalojë në disa faza.

-Faza e Parë do të jetë periudha për mbledhjen e opinioneve me shkrim nga individë dhe ekspertë të ndryshëm – deri në Nëntor 2019

-Faza e Dytë do të jetë diskutimi në publik i projekt-dokumentit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës – deri në Mars 2020

-Faza e Tretë do të jetë përmbledhja dhe miratimi i Strategjisë kombëtare – deri në Qershor 2020

Të treja fazat e mësipërme do të kenë fleksibilitet në funksion të realizimit të një dokumenti sa më të plotë. Strategjia 2021 - 2025 do të përafrojë zhvillimet më të fundit në politikën për diasporën shqiptare dhe do të vlerësojë qëllimet e saj për të ardhmen.

Ju faleminderit!



PËRMBAJTJA

Hyrje: Diaspora si Element Kombëtar.....	1
Migrimi i shqiptarëve dhe Diaspora	2
I. Situata aktuale.....	4
1.1 Situata aktuale dhe vlerësimi i saj	4
1.2 Faktorët e zhvendosjes së qytetarëve shqiptarë.....	4
1.3 Fenomeni i “rrjedhjes së trurit”	6
1.4 Migracioni dhe vendet fqinjë	7
1.5 Faktorizimi social dhe politik.....	8
1.6 Situata aktuale e Diasporës.....	8
1.7 Diaspora dhe integrimi në BE	9
1.8 Bashkëpunimi ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës.....	9
II. Vizioni, misioni dhe objektivat strategjike	9
2.1 Vizioni dhe misioni.....	9
2.2 Objektivat strategjike	10
2.2.1 Rrjetet e diasporës.....	10
2.2.2 Instrumente efektive	10
2.2.3 Diaspora shqiptare dhe zhvillimi ekonomik	11
2.2.4 Remitancat – nga konsumi në zhvillim.....	11
2.2.5 Kapitali njerëzor, shoqëror dhe kulturor	14
2.2.6 Ruajtja e identitetit kombëtar	14
2.2.7 Shkrimi dhe këndimi, arsimit dhe media	14
2.2.8 Organizimi i komuniteteve shqiptare jashtë vendit.....	15
2.2.9 Krijimi i një baze të dhënash për organizatat e Diasporës	15
2.2.10 Ngritja e qendrave të kulturës shqiptare	15
2.2.11 Avancimi i të drejtave të diasporës.....	15
2.2.12 E drejta për të votuar	16
2.2.13 Shërbimet konsullore dhe diplomacia	16
2.2.14 Diplomacia publike	16
2.3 Shtyllat kryesore të Strategjisë dhe aktivitetet e çdo shtylle	16
III. Krijimi i një kuadri gjithëpërfshirës institucional	20
3.1 Marrëdhëniet shtetërore me diasporën.....	20
3.2 Politikat shtetërore dhe diaspora.....	20
3.3 Komiteti Shtetëror për Diasporën	21

3.4 Nënkomisioni Parlamentar për Diasporën dhe Migracionin	21
3.5 Agjencia Kombëtare e Diasporës.....	22
3.6 Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës.....	22
3.7 Qendra e Botimeve për Diasporën	22
3.8 Këshilli Koordinues i Diasporës.....	23
IV. Buxheti dhe kostot	23
V. Zbatimi dhe Monitorimi.....	24
5.1 Angazhimet kryesore për secilën prej shtyllave për periudhën 2018-2024.....	24
5.2 Dimensionet funksionale të Zhvillimit dhe të Zbatimit të Strategjisë.....	26
5.3 Zbatimi i strategjisë	27
5.4 Krijimi i një kulture organizative dhe operacionale	27
5.5 Monitorimi dhe vlerësimi.....	28
5.6 Auditimi dhe Transparenca.....	28
Përfundime	28
Shtojca I – Plani i Veprimit: Strategjia për Diasporën shqiptare, 2018 – 2024 (bashkëlidhur më vete)	29
Shtojca II – Lista e aktiviteteve për çdo masë që prej strategjisë së parë (bashkëlidhur më vete)	29
Shtojca III – Udhërrëfytyesi i Strukturës së Qeverisjes (bashkëlidhur më vete).....	29

Diaspora përshkruhet sot si “një komunitet migrantësh që ruajnë lidhje materiale ose sentimentale me tokën mëmë duke u përshtatur në mjedisin dhe institucionet e shoqërisë pritëse”.¹ Në aspektin gjeografik, diasporat janë të përhapura në vende të ndryshme dhe përbëhen nga komunitete me moshë, breza dhe profesione të ndryshme. Për rrjedhojë, të ndryshme janë edhe arsyet se përse ata dëshirojnë t’i ruajnë lidhjet me atdheun e tyre.

Diaspora shqiptare ka një histori të gjatë. Ajo përfaqëson kryesisht Shqipërinë, Kosovën, Maqedoninë, Malin e Zi dhe Serbinë (luginën), pra vende të Ballkanit Perëndimor. Rreth 200.000 vetë migruan nga tokat shqiptare në shekullin e XV-të, kur ato u pushtuan nga osmanët.² Gjatë atyre shekujve, shqiptarët lëvizën brenda territorit të kësaj perandorie, madje duke pasur edhe pozicione mjaft të larta në hierarkinë e saj.

Arbëreshët, për shembull, të cilët jetojnë kryesisht në pjesën jugore të Italisë, janë një nga komunitetet më të vjetra që njihen si diasporë shqiptare. Arbëreshët vazhduan t’i ruanin me kujdes dhe me sukses rrënjët e tyre kulturore dhe gjuhësore shqiptare. Edhe Turqia është një vend i rëndësishëm për Diasporën shqiptare. Në fakt, historiografia turke e ka vlerësuar shumë rolin e madh që kanë luajtur shqiptarët jo vetëm në hierarkinë e Perandorisë osmane, por edhe më pas, në krijimin e shtetit të ri turk.

Migracioni i shqiptarëve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA) është konsoliduar me kohë. Në vitin 2012, Shoqata Kulturore “Vatra”, shoqata më e vjetër e shqiptarëve atje, festoi 100 vjetorin e saj.³ Diaspora shqiptare është e pranishme edhe në pjesë të tjera të botës, si në Europë, Australi dhe Afrikë. Në shtete si Rumania, Kanada, Kroacia, Ukraina, Egjipti dhe Argjentina, diaspora shqiptare organizon aktivitete nga më të ndryshmet, në mënyrë që të ruajë dhe të promovojë trashëgiminë e saj kulturore dhe gjuhësore. Në shumicën e vendeve pritëse, shqiptarët kanë krijuar organizatat dhe shoqatat e tyre komunitare. Për rrjedhojë, kjo kohë e plotë, e pasur dhe e shumëllojshme e vendos Diasporën shqiptare në një pozicion të rëndësishëm si një element kombëtar për të luajtur një rol aktiv dhe pjesëmarrës në zhvillimin e Shqipërisë.

¹ Migrants and the Host Society: Partnerships for Success (Geneva, Switzerland: International Organization for Migration, 2008), 17 [Shënim i përkthyesit për titullin e artikullit: “Migrantët dhe Shoqëritë Pritëse: Partneritete që çojnë në sukses”].

² Kosta Barjaba dhe Joniada Barjaba, "Embracing Emigration: The Migration-Development Nexus in Albania," Migrationpolicy.org, 10 shtator 2015, hulumtim i datës 27 mars 2019, <https://www.migrationpolicy.org/article/embracing-emigration-migration-development-nexus-albania> [Shënim i përkthyesit për titullin e artikullit: “Emigracioni për binomin migrim-zhvillim në Shqipëri”].

³ Nadëge Ragaru dhe Amilda Dymi. The Albanian-American Community in the United States. Canadian Review of Studies in Nationalism, 2004, 31 (1-2), pp.45-63. [Shënim i përkthyesit për titullin e artikullit: “Komuniteti shqiptaro-amerikan në Shtetet e Bashkuara të Amerikës”].

Diaspora shqiptare është një pasuri vërtetë e madhe për zhvillimin e vendit. Kjo strategji synon të mbështesë organizimin e komuniteteve shqiptare jashtë vendit, në mënyrë që të përmirësohet kapaciteti i diasporës që ajo të mund të luajë rolin e një partneri të rëndësishëm strategjik për të ardhmen e vendit. Si e tillë, strategjia do të bëjë edhe një rivlerësim të Diasporës si një faktor që do të ushtrojë ndikimin e vet tek atdheu dhe anasjelltas.

Objektivi i Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2018-2024 është që të prodhojë një kuadër të plotë për angazhimin e diasporës. Si e tillë, është hartuar në përputhje me Udhëzuesin e Bashkimit Europian (BE) për Politikën dhe me standardet ndërkombëtare. Strategjia synon të krijojë mekanizma që do ta mbështesin Diasporën shqiptare në mënyrë të ligjshme, si edhe angazhimin bashkëpunues të institucioneve shqiptare për bashkëkombasit e tyre që jetojnë jashtë vendit. Për më tepër, me strategjinë synohet të hartohen politika shtetërore, të cilat jo vetëm e njohin kontributin e komuniteteve të ndryshme të Diasporës shqiptare ndër vite, por edhe lehtësojnë dialogun me vendet pritëse për të promovuar marrëveshje dypalëshe në lidhje me Diasporën shqiptare.

Dokumenti përbëhet nga dy pjesë:

1. Strategjia Kombëtare për Diasporën dhe
2. Plani i Veprimit 2018-2024, që përfshin objektivat dhe masat kryesore që duhen zbatuar gjatë periudhës 2018-2024.

Strategjia Kombëtare për Diasporën dhe Plani i saj i Veprimit 2018-2024 u hartuan me kontributin e Grupit Ndërmintor të Punës kryesuar nga Ministri i Shtetit për Diasporën.⁴ Grupi Ndërmintor i Punës u mbështet nga një ekip ekspertësh kombëtarë dhe ndërkombëtarë, të cilët u angazhuan nga Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) në kuadër të programit "Angazhimi i Diasporës shqiptare për zhvillimin ekonomik-social të Shqipërisë". Përfshirë në të janë edhe kontributet dhe propozimet e ardhura nga shoqëria civile dhe organizatat ndërkombëtare.

MIGRIMI I SHQIPTARËVE DHE DIASPORA


Diaspora shqiptare u bazua kryesisht mbi tre valë të identifikuar migrimi:

1. vala e migrantëve përpara vitit 1944;
2. vala e migrantëve që u larguan gjatë periudhës së viteve 1945-1990, që përkon kryesisht me shqiptarët në ish Jugosllavi; dhe
3. vala e migrantëve pas rënies së komunizmit pas vitit 1990.

⁴ Grupi Ndërmintor i Punës drejtohet nga Ministri i Shtetit për Diasporën.

Popullsia shqiptare në Turqi u krijua gjatë tre valëve të mëdha të migrimit në periudha të ndryshme. E para ishte deportimi i shqiptarëve nga Kosova në vitin 1910, kur autoritetet serbe dëbuan 120.000 shqiptarë në Turqi⁵. Vala e dytë ishte gjatë viteve 1926-1938, kur rreth 400.000 emigruan në Turqi⁶. Ndërsa vala e fundit ishte pas Luftës së Dytë Botërore, në 1953-1966, kur rreth 400.000 shqiptarë u detyruan të emigronin në Turqi nga Kosova.⁷ Valë të tjera pati edhe ndërmjet viteve 1945-1990, për shembull, siç ishte migrimi shqiptar në ish Jugosllavinë dhe ai pas viteve 1990, kur shumë qytetarë shqiptarë u larguan nga Shqipëria, në veçanti në drejtim të Italisë. Po ashtu, duhet theksuar që pas trazirave të vitit 1997 në Shqipëri dhe luftës në Kosovë në 1998-1999⁸, pati një valë tjetër migrimi. Në fillim të viteve 2000, kishte emigruar pothuajse 25% e të gjithë popullsisë ose më shumë se 35% e krahut të punës. Siç shihet më poshtë, shifrat e qytetarëve që janë larguar nga Shqipëria kanë rënë gradualisht:

Fig 1: Popullsia mesatare vjetore dhe dy komponentët kryesorë, 2017



Burimi: INSTAT, 2017

⁵ Arjan Gjonca, *Communism, Health, and Lifestyle: The Paradox of Mortality Transition in Albania, 1950-1990* (Westport, CT: Greenwood Press, 2001), 10, hulumtim i datës 27 mars 2019 – me anën e Google Books. [Shënim i përkthyesit për titullin e artikullit: “Komunizmi, Shëndeti dhe Mënyra e të Jetuarit: Paradoksi i Tranzicionit të Vdekshmërisë në Shqipëri, 1950-1990”]

⁶ Po aty

⁷ Po aty

⁸ “NATO’s Role in Relation to the Conflict in Kosovo.” NATO & Kosovo: Historical Overview. Hulumtim i datës 28 mars 2019. <https://www.nato.int/kosovo/history.htm>. [Shënim i përkthyesit për titullin e artikullit: “Roli i NATO-s në konfliktin e Kosovës”]

Kohët e fundit, në kontinentin europian Shqipëria është bërë vendi që ka prodhuar fluskin më të madh të migracionit në bazë të raportit migrant-popullsi⁹.

I. SITUATA AKTUALE

1.1 SITUATA AKTUALE DHE VLERËSIMI I SAJ

Strategjia Kombëtare për Diasporën 2018-2024 synon të zhvillojë dhe të menaxhojë marrëdhëniet me Diasporën shqiptare. Ky dokument është një kuadër i qartë dhe sistematik për punën e institucioneve shtetërore në të ardhmen. Po ashtu, jep edhe një strukturë të qartë dhe rekomandime për menaxhimin e natyrës komplekse të angazhimit të diasporës. Plani i Veprimit 2018-2024 shtjellon të gjitha aktivitetet që duhen kryer gjatë periudhës së zbatimit të strategjisë. Si i tillë, ky është një dokument dinamik, i cili ka nevojë të vazhdueshme për monitorim dhe vlerësim.

Deri më tash, politikat publike për angazhimin e Diasporës shqiptare janë ndikuar përgjithësisht dhe në mënyrë sporadike nga donatorët dhe shoqëria civile. Në vitin 2004, qeveria shqiptare miratoi Strategjinë Kombëtare për Migrimin 2005-2010, e cila u përgatit me financimin e Bashkimit Europian dhe me mbështetjen e Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin. Ky ishte dokumenti i parë që synoi të gërshetonte interesin e shqiptarëve që jetojnë në Shqipëri dhe atyre që jetojnë jashtë vendit duke krijuar profilin e politikës shtetërore për këtë çështje.

Synimi i kësaj Strategjie është që ajo të jetë në koherencë me zbatimin e politikave të tjera shtetërore, që të trajtojë nevojat e komuniteteve jashtë vendit, të njohë kontributet e tyre dhe t'i përfshijë ata si partnerë zhvillimi për Shqipërinë :

1. duke krijuar një kulturë administrative dhe një kuadër të tillë për angazhimin e Diasporës;
2. duke çuar përpara të drejtat shoqërore dhe politike të anëtarëve të Diasporës shqiptare;
3. duke mbështetur organizimin e komuniteteve të Diasporës shqiptare jashtë vendit;
4. duke ndërtuar ura lidhëse ndërmjet Diasporës dhe Shqipërisë si partnerë zhvillimi për vendin.

1.2 FAKTORËT E ZHVENDOSJES SË QYTETARËVE SHQIPTARË

Në përgjithësi, njerëzit migrojnë kur u mungojnë burimet dhe mundësitë elementare për të përmbushur nevojat dhe aspiratat e tyre në atdhe. Këto faktorë shtytës që çojnë në migrim, mund të vendosen në grupet e mëposhtme:

Fig 2: Arsyet e largimit nga Shqipëria

⁹ Barjaba, Kosta. "Albania: Looking Beyond Borders", Migrationpolicy.org. March 02, 2017. Hulumtim i datës 28 mars 2019. <https://www.migrationpolicy.org/article/albania-looking-beyond-borders>. [Shënim i përkthyesit për titullin e artikullit: "Shqipëria: Të shohësh përtej Kufijve"]

FAKTORËT EKONOMIKË	SIGURIA PUBLIKE	INSTITUCIONE TË DOBËTA	GJAKMARRJA
<ul style="list-style-type: none"> Në përgjithësi, shqiptarët janë larguar nga Shqipëria për arsye ekonomike, si mungesa e mundësive për punësim, apo kushte të varfra jetese, veçanërisht në disa zona, ku mungojnë kushtet më elementare të jetesës, si për shembull energjia elektrike, furnizimi me ujë dhe strehimi. 	<ul style="list-style-type: none"> Shqipëria ka pasur flukse masive emigrimi në sajë të nivelit të ulët të sigurisë publike në vend apo të trazirave. Një numër i konsiderueshëm profesionistësh me kushte të mira ekonomike është larguar për një të ardhme më të sigurt për ata dhe familjet e tyre. Ky fenomen u vu re në veçanti gjatë trazirave të vitit 1998, të cilat sollën një valë tjetër migrimi. 	<ul style="list-style-type: none"> Qytetarëve u mungon besimi që situata në vend do të përmirësohet. Ata besojnë se korrupsioni dhe krimi i organizuar paralizojnë funksionimin normal të institucioneve shtetërore. Po ashtu, vështirësitë në zbatimin e ligjit dhe institucionet e dobëta pengojnë dëshirën për t'u kthyer, për më tepër kur tëkthyerit hasin vështirësi për të hapur një biznes apo për t'u kuptuar me administratën shtetërore. 	<ul style="list-style-type: none"> Rast i veçantë është largimi për shkak të gjakmarrjeve, traditë kjo mjaft problematike në veri të vendit, që rrjedh nga disa praktika shoqërore dhe kulturore.

Burimi: INSTAT, 2017

Një anketë e INSTAT-it kohët e fundit shpjegon faktorët kryesorë që kanë çuar në largimin e shqiptarëve nga vendi në vitin 2017, si për shembull: mundësi punësimi jashtë Shqipërisë (në rastin e individëve që kanë pasur punësim në Shqipëri, 84%), faktorë që kanë të bëjnë me familjen (4.6%), me papunësinë (4.2%), me mundësitë për të studiuar jashtë (3.5%) apo edhe faktorë të tjerë (3.6%).

FIG.3 FAKTORËT QË ÇOJNË NË LARGIMIN NGA SHQIPËRIA, 2017



Burimi: Anketa e Forcave të Punës, INSTAT, 2017

1.3 FENOMENI I “RRJEDHJES SË TRURIT”

Një karakteristikë e migrimit shqiptar ndër vite ka qenë niveli i lartë i profesionistëve të kualifikuar që janë larguar nga vendi. Hapja e Shqipërisë pas rënies së komunizmit hoqi pengesat dhe rriti aspiratat e qytetarëve shqiptarë për të lëvizur drejt vendeve më të zhvilluara, përfshirë shtetet fqinjë të BE-së, gjë që çoi në një rrjedhje të konsiderueshme të trurit.¹⁰ Në të u përfshinë akademikë, individë të kualifikuar në fusha të ndryshme, si edhe një numër i madh studentësh shqiptarë që studiojnë në universitete të huaja. Thuajse 50% e kërkuesve shkencorë, lektorëve dhe intelektualëve të vendit janë larguar nga Shqipëria që prej vitit 1990, më shumë se 26.3% të cilëve imigruan në SHBA.¹¹ Ndërsa në fillim të viteve 2000, rreth 60% e të diplomuarve në Perëndim, ose ishin larguar nga vendi, ose nuk ishin kthyer pas diplomimit.¹² Nga Italia dhe Greqia, truri i vendit ka shkuar në Kanada, SHBA, Gjermani, Britaninë e Madhe dhe vende të tjera të BE-së.

¹⁰ Mathias Lerch, "Internal and International Migration Across the Urban Hierarchy in Albania," Population Research and Policy Review 35, no. 6 (2016): , accessed March 28, 2019, doi:10.1007/s11113-016-9404-2. [Shënim i përkthyesit për titullin e artikullit: "Migracioni i brendshëm dhe ai jashtë vendit në hierarkinë urbane të Shqipërisë"]

¹¹ Gërmenji, E. and Gedeshi, I. 2008. "Highly Skilled Migration from Albania: An Assessment of Current Trends." Center for Economic and Social Studies in Tirana, Albania. Working Paper T-25. 16, accessed March 28, 2019, http://www.sussex.ac.uk/Units/SCMR/drc/publications/working_papers/WP-T25.pdf

¹² Gëdeshi Ilir, "From Brain Drain to Brain Gain: Mobilising Albania's Skilled Diaspora," Center for Economic and Social Studies in Tirana, Albania. [Shënim i përkthyesit për titullin e artikullit: "Nga largimi tek kthimi i trurit: Mobilizimi i Diasporës së kualifikuar shqiptare"]

“Humbja” e njerëzve të kualifikuar dhe të arsimuar është shkatërrimtare për zhvillimin ekonomik-social të vendit. Për këtë arsye, marrja e masave që parandalojnë largimin e përhershëm të individëve të kualifikuar dhe të arsimuar kërkon inkurajimin e migrimit qarkullues të individëve të kualifikuar në aspektin afatshkurtër dhe afatgjatë. Kjo vlen edhe për Diasporën shqiptare, e cila vuan për të arritur jashtë vendi pozicione që përkojnë me ekspertizën që ata ofrojnë. Ndaj ky do të jetë një element kyç që kjo Strategji do të marrë në konsideratë.

1.4 MIGRACIONI DHE VENDET FQINJË

Vendet fqinjë, si Greqia dhe Italia, shërbyen si destinacionet kryesore për migrantët shqiptarë gjatë viteve 1992-1995, për shkak të afërsisë me Shqipërinë dhe kostos së ulët të migrimit në vetvete. Sot mendohet se përafërsisht 1.44 milionë shqiptarë, ose 45% e totalit prej 3.2 milionë banorësh që banojnë në Shqipëri, kanë migruar dhe tashmë jetojnë jashtë vendit, kryesisht në Greqi dhe Itali.


Sipas të dhënave nga *Peoplemov.in*, në Greqi jetojnë 676.847 shqiptarë, ndërsa në Itali 522.647. Greqia ndodhet afër Shqipërisë gjeografikisht, kështu që kalimi i parregullt i kufirit shqiptaro-grek nuk kërkonte shpenzime të mëdha financiare. Po ashtu, qytetarët e të dy vendeve kanë ngjashmëri të dukshme kulturore dhe historike. Kërkuesit shkencorë e përshkruajnë migrimin drejt Greqisë si migrim ekonomik me një shkallë të lartë parregullsie dhe flukse migrantësh pa dokumente.

Italia ishte vend destinacioni, në të cilin ndërthureshin preferencat kulturore me afërsinë gjeografike. Duhet theksuar që italishtja është gjuha e huaj që flitet më shumë në Shqipëri, ndërkohë që arti dhe kultura italiane ndiqen po aq shumë. Këto faktorë ndihmojnë për të kuptuar arsyet se përse Italia ishte një nga vendet më të kërkuara nga emigrantët shqiptarë. Deri në mes të vitit 2005, shqiptarët ishin komuniteti më i madh i migrantëve në Itali.

Që atëherë, lëvizja e shpeshtë e migrantëve nga atdheu i tyre drejt vendeve pritëse është normalizuar në sajë të procesit të rregullimit të statusit ligjor në Itali dhe Greqi, si edhe për shkak të liberalizimit të vizave. Kjo gjë ka krijuar një diasporë më të thellë shqiptare në këto vende, e cila përqendrohet në stabilizimin e statusit ligjor dhe shoqëror në vendet pritëse për brezin tjetër. Këto elementë, së bashku me të dhëna të tjera, mund të orientojnë fokusin gjeografik të ndërhyrjeve të hershme të kësaj strategjie.

Përveç vendeve fqinjë, *Peoplemov.in* ka identifikuar edhe 10 shtetet me numrin më të madh të migrantëve shqiptarë:

FIG 4: TË DHËNA NGA PEOPLEMOV.IN PËR SHQIPËRINË



BURIMI: PEOPLEMOV.IN

1.5 FAKTORIZIMI SOCIAL DHE POLITIK

Një karakteristikë dalluese e migracionit shqiptar, veçanërisht në vende si Greqia apo Italia, ka qenë krijimi i organizatave që bazohen tek interesi i partive politike në Shqipëri. Partitë politike luajnë një rol të rëndësishëm për t'i nxitur bashkëqytetarët e tyre që të votojnë në procese zgjedhore në Shqipëri, pasi votat e tyre konsiderohen të rëndësishme për zgjedhjet. Kjo gjë ka krijuar mundësi për përfaqësimin e kandidatëve me nënshtetësi shqiptare edhe në strukturat politike, sociale dhe përfaqësuese të vendeve pritëse.

1.6 SITUATA AKTUALE E DIASPORËS

Siç u tregua më lart, diaspora shqiptare, e cila është e shumëllojshme, gjendet në shtete të ndryshme, si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Kanada, Mbretëri të Bashkuar, Gjermani, Greqi, Itali, Turqi, Zvicër, Norvegji, Suedi, Finlandë dhe Francë, por edhe në Australi. Diaspora ka filluar të organizohet. Ajo ka nivel të lartë arsimor dhe ka dëshirë të mbajë lidhjet me atdheun. Për rrjedhojë, qeveria shqiptare duhet të vazhdojë të thellojë lidhjet me diasporën duke e parë atë si një partner strategjik për zhvillimin e vendit. Është thelbësore që Shqipëria jo vetëm të komunikojë, por edhe ta angazhojë diasporën, rrjetet e saj, aftësitë dhe ekspertizën që ajo ka.

Organizatave të diasporës shqiptare po luajnë një rol gjithnjë e më rritje si urë lidhëse ndërmjet vendeve pritëse dhe vendit nga vijnë. Për këtë arsye, organizatat e diasporës shqiptare në Perëndim përqendrohen më shumë tek ndërtimi i kapaciteteve të organizatës së tyre në vendin pritës dhe tek përparësitë e tyre të brendshme. Ata trajtojnë kryesisht çështje që kanë të bëjnë me situatën e anëtarëve të diasporës, me nevojat e tyre, me kërkesat që ata kanë në lidhje me pjesëmarrjen politike dhe të drejtat e punëtorëve të huaj, marrjen e nënshtetësisë dhe të drejtat e komuniteteve fetare. Një nga avantazhet e diasporës shqiptare ka qenë mobilizimi për një kauzë të caktuar,

nëpërmjet lobimit të tërthortë, me qëllim bindjen e qeverisë së vendit pritës që të vepronte në mbështetje të vendit të origjinës. Një shembull mjaft i mirë janë përpjekjet e diasporës shqiptare gjatë Luftës së Kosovës.

1.7 DIASPORA DHE INTEGRIMI NË BE

Diaspora dhe migrimi mund të luajnë një rol thelbësor në procesin e integrimit të Shqipërisë në BE, pasi migrimi ka qenë një temë e rëndësishme e politikës së BE-së gjatë viteve të fundit. Në Strategjinë Europiane 2020 dhe në Programin e Stokholmit është shprehur qartë potenciali dhe kontributi i madh i migrantëve për BE-në dhe për ndërtimin e një ekonomie të qëndrueshme dhe konkurruese në këtë rajon. Duke marrë parasysh të ardhmen e Shqipërisë dhe negociatat me BE-në, Shqipëria duhet ta shikojë diasporën e saj si një aleat të rëndësishëm për të çuar përpara procesin e integrimit evropian.

1.8 BASHKËPUNIMI NDËRMJET SHQIPËRISË DHE KOSOVËS

Angazhimi dhe përfshirja e diasporës është një mënyrë për të promovuar bashkëpunimin ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, duke pasur parasysh potencialin që ekziston për një angazhim më të madh për t'iu shërbyer bashkëqytetarëve jashtë vendit, për të rritur ndërveprimin social dhe për të shkëmbyer njohuri në fusha të ndryshme. Strategjia parashikon një bashkëpunim të ngushtë me institucionet e Kosovës për të hyrë në rrugën e dialogut të hapur dhe për t'i drejtuar marrëdhëniet e komuniteteve të diasporave. Për rrjedhojë, nënshkrimi i disa marrëveshjeve të përbashkëta ka qenë hapi i parë në këtë drejtim. Megjithatë, hartimi i një Plani të përbashkët Veprimi do të ishte një hap jo vetëm i rëndësishëm, por edhe i domosdoshëm në këtë aspekt. Për më tepër, të dyja vendet do të vlerësojnë nivelin e përbashkët të bashkëpunimit me Maqedoninë e Veriut, me Malin e Zi dhe Serbinë, si një përpjekje për të bashkërenduar punën e institucioneve përgjegjëse për të drejtat e diasporës shqiptare në vendet e tyre të origjinës.

II. VIZIONI, MISIONI DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKË

2.1 VIZIONI DHE MISIONI

Në këtë dokument pasqyrohet puna e vazhdueshme që duhet të bëjnë institucionet shtetërore për të pasur një strategji të re për angazhimin dhe përfshirjen e diasporës. **Vizioni** i Strategjisë Kombëtare ka për synim rivlerësimin e angazhimit të diasporës duke u bazuar në situatën aktuale dhe në strukturën cilësore të marrëdhënieve të shtetit shqiptar me diasporën. Vizioni ka të bëjë me lidhjen që kanë komunitetet e diasporës me atdheun dhe në të njëjtën kohë duke kuptuar si interesat e zhvillimit të vendit, ashtu edhe rëndësinë e ruajtjes së identitetit kombëtar dhe të trashëgimisë kulturore.

Misioni i Strategjisë Kombëtare ka për synim fuqizimin e rolit të diasporës në zhvillimin e vendit nëpërmjet pasurisë që ata sjellin, si njohuritë, ekspertiza dhe përvoja. **Vlera thelbësore** që kërkon të arrijë ky dokument është krijimi i besimit ndërmjet diasporës dhe institucioneve shtetërore të Shqipërisë. Në të gjenden edhe ndryshime të politikave shtetërore, të cilat bëjnë të mundur fuqizimin e marrëdhënies ndërmjet diasporës së Shqipërisë dhe tokës mëmë.

2.2 OBJEKTIVAT STRATEGJIKË

Kjo strategji përqendrohet në një sërë objektivash strategjike që ndihmojnë fokusin e aktiviteteve që do të organizohen nëpërmjet Planit të Veprimit. Për objektivat është marrë parasysh nevoja për të ruajtur kuadrin institucional për angazhimin e diasporës, si edhe përcaktimi i komponentëve kyçë tematikë dhe operacionalë për zbatimin e strategjisë.

2.2.1 RRJETET E DIASPORËS

Është menduar që strategjia të mbështesë rrjetet ekzistuese të diasporës dhe të kontribuojë në krijimin e rrjeteve të reja të diasporës për të mbështetur siç duhet aktivitetet kyçe të strategjisë. Kjo do të thotë krijimin e rrjeteve të posaçme që do të bëjnë të mundur aktivitetet e parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë, përfshirë zhvillimin e rrjeteve funksionale të biznesit, rrjete informimi dhe për mediat, rrjetet e gjeneratës tjetër (në të ardhmen), rrjete profesionale dhe rrjete grash. Strategjia do të duhet të inkurajojë një ndryshim mendësie në momente të caktuara, në mënyrë që të japë rezultatet e saj. Rrjetet e mësipërme janë menduar si portale kritike nëpërmjet së cilave qeveria dhe diaspora mund të bashkëpunojnë për të sjellë ndryshime progresive.

Në lidhje me diasporën, ndërtimi i rrjeteve funksionale përfshin edhe planifikimin dhe zbatimin e fushatave të informimit dhe të rritjes së ndërgjegjësimit për:

1. çështje që kanë të bëjnë me migrimin dhe diasporën;
2. regjistrimin e migrantëve për votim dhe të drejtën e votës (pas miratimit në Kuvend);
3. identitetin dhe kulturën e shqiptarëve, për historinë e Shqipërisë tek komunitetet e diasporës;
4. burime informacioni për çështje që ndikojnë migrimin dhe diasporën, si edhe çështje që kanë të bëjnë me zhvillimet e fundit politike, sociale dhe ekonomike në vend.

Pjesë përbërëse dhe e rëndësishme e Planit të Veprimit është krijimi i rrjeteve të qëndrueshme të bashkëpunimit me organizata dhe institucione të ndryshme që merren me këto çështje dhe me shoqërinë civile si në vendin pritës, ashtu edhe në Shqipëri. Me anën e çmimit “Ambasador i Kombit” është menduar krijimi i një grupi profesionistësh me emër në fushat e tyre, jo vetëm për të festuar në mënyrë aktive arritjet e tyre, por edhe që ata të jenë “ruajtësit e portave” të këtyre rrjeteve.

2.2.2 INSTRUMENTE EFEKTIVE

Strategjia do të synojë të krijojë bazën e duhur të instrumenteve efektive për orientuar dhe çuar përpara objektivat e shtjelluar në të, përfshirë mbështetje për organizatat shqiptare të diasporës për të krijuar struktura këshillimore vendore për shtetasit e huaj në ato qytete ku janë të përqendruar migrantët shqiptarë, sipas udhëzuesit të Kongresit të Autoriteteve Vendore dhe Rajonale dhe Këshillit të Europës. Në këtë mënyrë ata do të kenë mundësi të avokojnë për marrëveshje dypalëshe për mbrojtjen sociale të migrantëve me vendet pritëse, në mënyrë që migrantët të mund të transferojnë sigurimet shoqërore në Shqipëri. Do të bëhet edhe një rivlerësim i mënyrë së llogaritjes apo mbledhjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe, nëse do të jetë e nevojshme, edhe nënshkrimi i marrëveshjeve ndërmjet Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe bankave. Në këtë kuadër, do të kryhet edhe një vlerësim i një Plani të posaçëm Veprimi për pensionet e migrantëve shqiptarë. Strategjia do të avokojë edhe për personat vulnerabël të Diasporës shqiptare nëpërmjet fushatave të avokacisë dhe të informimit dhe do të punohet edhe për mbrojtjen e të drejtave të Diasporës.

2.2.3 DIASPORA SHQIPTARE DHE ZHVILLIMI EKONOMIK

Përfshirja e Diasporës shqiptare në zhvillimin ekonomik të vendit do të përqendrohet në këto fusha:

1. krijimin e një Dhome Tregtie Biznesi të Diasporës;
2. ofrimi i një kuadri ligjor për investimet nga Diaspora; dhe
3. ngritjen e një Skeme Bashkërendimi dhe Rrjetëzimi të Profesionistëve të Diasporës.

Ky komponent do të realizohet ngushtësisht me Kosovën, ndaj një hap i rëndësishëm në këtë aspekt do të jetë hartimi i një plani të përbashkët institucionale me zyrën e IOM-it në Tiranë. Strategjia Kombëtare do të nxisë pjesëmarrjen e diasporës në procesin e zhvillimit ekonomik të vendit. Për më tepër, do të inkurajohet përthithja e investimeve të diasporës, krijimi i ndërmarrjeve të vogla e të mesme në disa fusha, përfshirë bujqësinë, industrinë e ushqimit dhe zhvillimin e zonave rurale. Me anën e Strategjisë Kombëtare do të punohet për të krijuar një klimë të favorshme për investimet nga diaspora nëpërmjet aktiviteteve për stimuj fiskalë, shpërndarje informacioni, duke ulur korrupsionin, risqet, apo duke përmirësuar elementë të tjerë që e bëjnë të mundur klimën e investimeve. Strategjia është hartuar duke marrë parasysh pjesëmarrjen aktive të të gjithë aktorëve që nevojiten për të siguruar një klimë të tillë që lehtëson dhe favorizon investimet.


Strategjia synon të ketë harmonizim me planet vendore dhe sektoriale zhvillimore që po zbatohen nga ministritë e tjera të linjës, duke e pozicionuar diasporën si një vlerë të shtuar për këto plane zhvillimi. Përfshirja në një kuadër specifik sektorial do të ofrojë angazhim të posaçëm nga diaspora duke qenë në përputhje edhe me synimet e vetë komunitetit të diasporës. Për më tepër, strategjia do të synojë të ofrojë qasje në të gjithë gamën e potencialit të investimeve, duke mbështetur si ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, ashtu edhe zhvillimin e madh infrastrukturor.

Strategjia Kombëtare e Diasporës do të inkurajojë bashkërendimin dhe organizojë takime të ndryshme, si “Ditët e Shqipërisë” në vende ku gjendet diaspora shqiptare, duke u mbështetur në një program vjetor apo në aktivitete të tjera periodike, që promovojnë turizmin shqiptar dhe lehtësojnë investimet në vend.

2.2.4 REMITANCAT – NGA KONSUMI NË ZHVILLIM

Remitancat, ose dërgesat në para të migrantëve, kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm përgjithësisht për konsumin apo mbijetesën e përditshme të familjeve shqiptare. Me anën e dërgesave në para familjet kanë përmbushur nevojat e tyre bazë për ushqim, veshmbathje, ilaçe, apo për ndërtimin dhe mobilimin e shtëpisë. Është e rëndësishme të theksohet varësia e ekonomisë shqiptare tek remitancat, që janë rreth 9-15 për qind e PBB-së së vendit dhe rreth 15% e të ardhurave të familjeve shqiptare. Kjo është arsyeja se pse Shqipëria renditet në listën e vendeve me varësi të lartë tek remitancat, siç njihen ndryshe dërgesat në para.

FIG 5: DINAMIKA E DËRGESAVE NË PARA TË MIGRANTËVE SHQIPTARË, 2002-2016




BURIMI: OPEN DATA ALBANIA, 2016 & BANKA E SHQIPËRISË, 2016

Dinamika e remitancave në Shqipëri ka kaluar 3 faza:

1. rritjen e tyre nga viti 1991 deri në vitin 2007;
2. rënien në periudhën 2008-2013; dhe
3. ripërtëritjen që prej vitit 2014.

Remitancat vazhduan të rriteshin nga viti 1991 deri në vitin 2007, kur ato arritën nivelin e tyre maksimal. Në vitin 2007, në Shqipëri vlera e remitancave ishte 952 milionë euro, duke qenë vendi me varësinë më të madhe ndaj dërgesave në para në rajon, me më shumë se 300 euro për banor. Pas këtij viti, remitancat ranë duke arritur pikën e tyre më të ulët në vitin 2013 më shifrën nën 500 milion euro, rënie kjo e cila shkaktoi rritje të varfërisë. Dërgesat në para filluan të pësojnë rritje sërish në vitin 2014 duke arritur shifrën 592 milion euro dhe në vitin 2016 shifrën 616 milion euro.

FIG 6: PERFORMANCA E DËRGESAVE NË PARA NË PERIUdhËN 1993-2016



BURIMI: BANKA E SHQIPËRISË (SHIFRAT JANË KONVERTUAR NË USD DHE, PËR RRJEDHOJË, KANË NDIKIM EDHE TEK NORMA E SHKËMBIMIT ME MONEDHAT E TJERA)

Varësia e lartë tek remitancat kërkon menaxhim strategjik. Në këtë kontekst, ekziston një mundësi e mirë për të promovuar ndërthurjen në ekonomi të remitancave me burime të tjera zhvillimi, si tregtia apo investimet e huaja të drejtpërdrejta. Kanalizimi i dërgesave në para drejt mekanizmave formalë rrit transparencën dhe promovon sistemin bankar në Shqipëri duke rritur fuqinë e tregut të remitancave. Në Strategji parashikohet promovimi i transfertave me kosto më të ulët nëpërmjet kanaleve formale, në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare dhe qeveritë e vendeve pritëse.

Dërgesat e migrantëve do të konsiderohen si një nga instrumentet e rëndësishme të zhvillimit të vendit. Strategjia Kombëtare për Diasporën parashikon bashkërendimin në nivel kombëtar të punës së institucioneve përgjegjëse shtetërore për të hartuar me njëri-tjetrin një plan veprimi për remitancat, i cili:

1. do të identifikojë praktikatat e mira për dërgesat në para;
2. do të shtrijë më gjerë shërbimet bankare në Shqipëri dhe do të përmirësojë bashkëpunimin ndërmjet bankave shqiptare dhe simotrave të huaja për remitancat;
3. do të zgjerojë kapacitetet e institucioneve të tjera financiare dhe të Postës shqiptare për të përmirësuar shërbimin e transfertave të dërgesave në para;
4. do të rrisë kapacitetet e institucioneve shtetërore dhe organizatave të diasporës në vendet pritëse për të bashkëpunuar me njëri-tjetrin për hartimin e iniciativave të përbashkëta, si edhe
5. do të inkurajojë kanalizimin e remitancave bankare dhe marrjen e hapave të duhura praktike që dërgesat në para të përdoren për zhvillimin e Shqipërisë.

2.2.5 KAPITALI NJERËZOR, SHOQËROR DHE KULTUROR

Me kalimin e viteve, Diaspora shqiptare ka krijuar një kapital të konsiderueshëm jomonetar, ose një kapital të rëndësishëm njerëzor, shoqëror dhe kapital. Diaspora mund të japë një kontribut të vlefshëm për Shqipërinë jo vetëm duke u kthyer fizikisht në vend, apo duke transferuar kapitalin e vet financiar, por edhe nëpërmjet lidhjeve që ata kanë, apo nëpërmjet njohurive dhe aftësive që ata kanë përfutur. Strategjia Kombëtare do të përkrahë praktikën e “ftesave të hapura” për projekte që promovohen brenda diasporës. Për këtë arsye, Fondi i Zhvillimit të Diasporës do të inkurajojë profesionistë të ndryshëm nga diaspora që të aplikojnë në projekte të ndryshme duke bërë të mundur kështu transferimin e njohurive dhe të praktikave më të mira. Strategjia do të kryejë një rivlerësim të bashkëpunimit me donatorët dhe me programet e modelit “Brain Gain” ose “Rikthimi i Trurit” me synim krijimin e strukturave institucionale që bëjnë të mundur tërheqjen e profesionistëve të diasporës për angazhime afatshkurtra dhe afatgjata.

2.2.6 RUAJTJA E IDENTITETIT KOMBËTAR

Identiteti i diasporës është një strukturë sociale që zhvillohet ndër vite. Strategjia parashikon rritjen e kontributit të Diasporës dhe bashkëpunimin e qeverise dhe institucioneve shtetërore për ruajtjen dhe forcimin e identitetit kombëtar të qytetarëve shqiptarë.

2.2.7 SHKRIMI DHE KËNDIMI, ARSIMI DHE MEDIA

Diaspora shqiptare, me karakteristikat dhe traditat e saj të veçanta kulturore, i inkurajon brezat e rinj që të ruajnë identitetin e tyre kombëtar si pjesë e diasporës, edhe pse jetojnë në shoqëri pritëse apo edhe pse kanë identitete hibride. Strategjia Kombëtare fokusohet tek ruajtja e identitetit kulturor, gjuhësor dhe kombëtar të diasporës. Kjo do të arrihet në rast se diaspora dhe Shqipëria, si vendi i origjinës, bashkëpunojnë ngushtë me njëri-tjetrin. Për këtë arsye, angazhimi dhe përfshirja në projekte specifike kulturore dhe arsimore do të parandalojë asimilimin e mëtejshëm gjuhësor, veçanërisht tek brezat e dytë dhe të tretë të diasporës.

Për këtë lypsen kurse dhe mësues të gjuhës shqipe që të punojnë në klasa të veçanta gjuhe. Prandaj Strategji parashikon nënshkrimin e marrëveshjeve të posaçme me institucionet shtetërore të Kosovës, gjë që kërkon që administratat e Shqipërisë dhe të Kosovës të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën në mënyrë që të hartojnë politika dhe programe arsimore që do të ishin të pëlqyeshme për brezat e rinj. Duke pasur parasysh këtë synim, Strategjia do të bëjë të mundur aktivitete digjitale duke promovuar platforma të reja të mediave sociale, të cilat do të mund të plotësojnë format tradicionale të angazhimit në këtë fushë.

2.2.8 ORGANIZIMI I KOMUNITETEVE SHQIPTARE JASHTË VENDIT

Organizimi i komuniteteve shqiptare jashtë vendit shpjegohet më qartë në figurën e mëposhtme. Ai ka për synim:

FIG 7: ORGANIZIMI I KOMUNITETEVE SHQIPTARE JASHTË VENDIT



2.2.9 KRIJIMI I NJË BAZE TË DHËNASH PËR ORGANIZATAT E DIASPORËS

Baza e të dhënave për organizatat e diasporës do të jetë një mekanizëm i rëndësishëm informacioni për memorien institucionale jo vetëm për momentin aktual, por edhe për të ardhmen. Ajo do të luajë disa role:

1. do të mbështesë të drejtën e diasporës për të votuar;
2. do të ndihmojë ngritjen e rrjeteve profesionale jashtë vendit; dhe
3. do të funksionojë si një server me informacion për potencialin dhe kapacitetet e diasporës sipas profesioneve.

2.2.10 NGRITJA E QENDRAVE TË KULTURËS SHQIPTARE

Ngritja e qendrave të kulturës shqiptare në vendet pritëse do të arrihet në bashkëpunim me Kosovën. Synimi i këtyre qendrave do të jetë ruajtja e identitetit kombëtar, promovimi i imazhit të vendeve të origjinës, si edhe ofrimi i shërbimeve dhe i informacioneve tek komunitetet shqiptare në vendet pritëse.

2.2.11 AVANCIMI I TË DREJTAVE TË DIASPORËS

Avancimi i të drejtave të Diasporës do të kërkojë veprime të bashkërenduara nga qeveria dhe institucionet shtetërore me organizatat e diasporës shqiptare. Do të promovohen politika të qarta dialogu me vendet pritëse për çështje të rëndësishme, si integrimi, mësimi i gjuhës amtare dhe politikat për qytetarinë. Strategjia do të inkurajojë bashkëpunimin shtetëror me ato organe të shteteve pritëse, që mbulojnë çështjet e migrantëve, të drejtat e grave e të fëmijëve. Po ashtu, do të promovohet edhe ngritja e komiteteve dypalëshe konsultative të nivelit të lartë për

mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve të diasporës shqiptare. Në vendet pritëse, organizatat e diasporës do të përkrahen për të mbështetur shqiptarët që punojnë e jetojnë atje, për nevojat që ata mund të kenë, për informacionin dhe shërbimet që mund t'u duhen të gjithëve, përfshirë të rinjve migrantë, për pjesëmarrjen politike, të drejtat e punës, procesin e natyralizimit, të drejtat fetare apo çështje të tjera.

Diaspora mund të jetë një nga faktorët më të rëndësishëm për zhvillimin e shoqërisë civile në Shqipëri, nëpërmjet ndërmjetësimit, ndarjes së ideve, praktikave, vlerave, normave të sjelljes dhe remitancat sociale. Migrantët e rritur e të rinj mund të luajnë një rol kyç për të ndihmuar zhvillimin dhe financimin e partnerëve vendorë.

2.2.12 E DREJTA PËR TË VOTUAR

Strategjia parashikon marrjen e disa hapave për të ndryshuar kuadrin ligjor shqiptar, në mënyrë që të mirëpritet dhe të respektohet roli i diasporës dhe migrimit të rregullt. Përfshirja e diasporës në sistemin zgjedhor dhe politik është e rëndësishme, pasi bën të mundur angazhimin dhe përfshirjen e ekspertizës në administratën shtetërore.

2.2.13 SHËRBIMET KONSULLORE DHE DIPLOMACIA

Strategjia do të mbështesë përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në vendet me komunitetet më të mëdha të diasporës shqiptare. Ambasadat dhe konsullatat do të përpilojnë raporte periodike për situatën dhe organizimin e diasporës shqiptare. Me qëllim mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve shqiptarë, ambasadat dhe zyrat konsullore të Republikës së Shqipërisë do të kenë në dispozicion ekspertë ligjorë të specializuar për çështjet e migrimit dhe të drejtat e njeriut, me nivel të lartë njohurish për rregullat dhe praktikën e imigrimit në vendet pritëse.

Strategjia Kombëtare do të rrisë ndërgjegjësimin tek qytetarët shqiptarë jashtë vendit për përdorimin e shërbimeve konsullore dhe diplomatike që ofrohen nga përfaqësitë shqiptare nëpërmjet platformës konsullore elektronike. Në të do të ketë informacion për organizatat joqeveritare të akredituara në vendin pritës, që ofrojnë asistencë ligjore dhe mbrojtje për komunitetet e të huajve.

2.2.14 DIPLOMACIA PUBLIKE

Strategjia do të thellojë më tej diplomacinë publike dhe fuqinë e butë të Shqipërisë dhe do të promovojë dhe inkurajojë influencuesit e diasporës, ose "ambasadorët e kombit" për të avancuar imazhin pozitiv të kombit shqiptar. Po ashtu, autoritetet shtetërore, ose më vete, ose në bashkëpunim me vendet pritëse apo donatorë të interesuar, do të financojnë organizata gjithëpërfshirëse migrantësh. Qendrat kulturore do të përfshihen në shpërndarjen e informacionit dhe organizimin e aktiviteteve të ndryshme për të ruajtur dhe për të forcuar identitetin kombëtar tek diaspora dhe për të promovuar Shqipërinë në botë.

2.3 SHTYLLAT KRYESORE TË STRATEGJISË DHE AKTIVITETET E ÇDO SHTYLLE

Strategjia është e mbështetur në pesë shtylla kryesore strategjike, me anë të të cilave synohet arritja e objektivave të sipërpërmendura. Këto shtylla janë:

- Shtylla 1 – Qeverisja dhe Menaxhimi i Njohurive
- Shtylla 2 – Avancimi i Programit të të Drejtave Politike dhe Sociale të Diasporës
- Shtylla 3 – Programi për Kapitalin e Diasporës, Lidhjet e tyre dhe Ruajtjen e Kulturës shqiptare
- Shtylla 4 – Përfshirja e Diasporës në Programin e Zhvillimit ekonomik-social të vendit
- Shtylla 5 – Monitorimi dhe Vlerësimi

Brenda secilës prej këtyre shtyllave janë përcaktuar një sërë aktivitete, nëpërmjet të cilave do të përmbushet misioni i kësaj strategjie dhe do të arrihet vizioni i saj. Sukses i aktiviteteve kërkon udhëheqje të fortë nga qeveria e Shqipërisë, nga diaspora, por edhe nga partnerët e ndryshëm.

Fig 8: Përmbledhje e aktiviteteve sipas shtyllave përkatëse të Strategjisë

Shtylla 1 - Qeverisja dhe Menaxhimi i Njohurive

- 1.1 Krijimi i një kulture të re administrative (2018 - 2024)
- 1.2 Ndërtimi i partneriteteve me komunitetin e donatorëve (2019 - 2024)
- 1.3 Diplomacia për Diasporën (2019 - 2024)
- 1.4 Qendër Hulumtimi dhe Trajnimi për Diasporën (2020 - 2024)

Shtylla 2 - Avancimi i Programit të të Drejtave Politike dhe Sociale të Diasporës

- 2.1 Samiti i Diasporës (2019 - 2024)
- 2.2 Programi i mbështetjes së diasporës shqiptare (2019 - 2024)
- 2.3 Iniciativa "Shqipëria bën avokaci" (2019 - 2024)
- 2.4 Portali për komunikimin dhe median (2020 - 2024)

Shtylla 3 - Programi për Kapitalin e Diasporës, Lidhjet e tyre dhe Ruajtjen e Kulturës shqiptare

- 3.1 Programi "Fellows and Scholars" (2019 - 2024)
- 3.2 Çmimi "Ambasador i Kombit" (2018 - 2024)
- 3.3 "Ngrije zërin Shqipëri!" (2020 - 2024)
- 3.4 Rrjeti i Grave të Diasporës Shqiptare (2020 - 2024)
- 3.5 Java Kulturore (2021 - 2024)

Shtylla 4 - Përfshirja e Diasporës shqiptare në Zhvillimin ekonomik-social të vendit

- 4.1 Programi "Connect Albania" (2018 - 2024)
- 4.2 Rrjeti Global i Profesionistëve Shqiptarë (2020 - 2024)
- 4.3 Programi "Me origjinë shqiptare" (2020 - 2024)
- 4.4 Programi "Diaspora vepron": Remitancat dhe sfidat e investimeve (2020 - 2024)

Shtylla 5 - Monitorimi dhe Vlerësimi

- 5.1 Rishikimi afatmesëm 2021
- 5.2 Rishikimi i Strategjisë dhe hartimi i Planit të Veprimit, 2025 - 2030)

PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE SIPAS SHTYLLAVE PËRKATËSE

SHTYLLA 1: QEVERISJA DHE MENAXHIMI I NJOHURIVE

AKTIVITETET 1.1 – KRIJIMI I NJË KULTURE TË RE ADMINISTRATIVE

Këto aktivitete do të përqendrohen tek zhvillimi dhe institucionalizimi i agjencisë kyçe dhe i praktikave legislative e ministeriale për të ndërtuar dhe për të ruajtur angazhimin e diasporës. Do të fokusohen tek ngritja e institucioneve

kyçe të shtjelluara më tej në dokumentin strategjik, së bashku me institucionalizimin e një kulture të re praktike në administratë, më qëllim sigurimin e koherencës si në nivel politikash, ashtu edhe në nivel zbatimi.

AKTIVITETET 1.2 – KRIJIMI I PARTNERITETEVE ME KOMUNITETIN E DONATORËVE

Këto aktivitete do të përqendrohen tek përmirësimi i menaxhimit të marrëdhënies me donatorët më synim sigurimin e mbështetjes shtesë financiare për zbatimin e kësaj politike. Këto aktivitete do të përfshijnë hartimin e një indeksi prospekti, një konferencë dhe një mekanizëm bashkërendimi për donatorët e interesuar në përfshirjen e diasporës.

AKTIVITETET 1.3 DIPLOMACIA DHE PËRFSHIRJA E DIASPORËS

Këto aktivitete do të përqendrohen tek përpjekjet për të zgjeruar gamën diplomatike të angazhimit të diasporës brenda aparatit institucional të qeverisë, duke përfshirë masat në vijimësi të dokumentit strategjik për të përmirësuar angazhimin dhe bashkëpunimin e diplomacisë dhe të diasporës ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës.

AKTIVITETET 1.4 – QENDËR HULUMTIMI DHE TRAJNIMI PËR DIASPORËN

Këto aktivitete do të përqendrohen tek njohuritë dhe kapacitetet operacionale të qeverisë së Shqipërisë për të shtuar angazhimin dhe përfshirjen e diasporës, duke përfshirë masa analitike të nivelit të lartë, si hulumtim apo kërkim shkencor, apo edhe trajnime për përfshirjen e diasporës me përfaqësuesit e qeverisë së Shqipërisë.

SHTYLLA 2: AVANCIMI I PROGRAMIT TË TË DREJTAVE POLITIKE DHE SOCIALE TË DIASPORËS

AKTIVITETET 2.1 SAMITI I DIASPORËS:

Këto aktivitete do të përqendrohen tek organizimi i disa samiteve të diasporës në përputhje me punën në vijimësi të qeverisë shqiptare. Me anën e samiteve, qeveria do të ketë mundësinë të rilidhet me komunitetet shqiptare jashtë vendit, ndërkohë që samitet mund të shërbejnë si platformë që diaspora të jetë pjesëmarrëse aktive për përpilimin e përfshirjes së saj në jetën e vendit.

AKTIVITETET 2.2 PROGRAM PËR MBËSHTETJEN E DIASPORËS SHQIPTARE

Këto aktivitete do të përqendrohen tek rritja e ndërgjegjësimit të komuniteteve të diasporës shqiptare duke hartuar analiza, duke ndërtuar ura lidhëse dhe duke ofruar shërbime. Programi do të mbështesë infrastrukturën e komuniteteve të diasporës, si edhe organizatat e tyre. Do të fillojë të promovojë edhe ngritjen e organizatave të reja të diasporës me qëllim thellimin e rrjetit të organizatave, duke i shërbyer komunitetit të diasporës në fusha si arti, biznesi, kultura dhe arsimit.

AKTIVITETET 2.3 INICIATIVA “SHQIPËRIA BËN AVOKACI”

Këto aktivitete do të përqendrohen tek avokacia që do të bëjë qeveria shqiptare në emër të diasporës së saj, duke rritur ndërgjegjësimin për çështje që kanë të bëjnë me cënueshmërinë ose vulnerabilitetin e diasporës, dhe duke u ofruar anëtarëve më vulnerabël të diasporës mbështetje përkatëse.

AKTIVITETET 2.4 PORTALI I DIASPORËS PËR KOMUNIKIMIN DHE MEDIAT

Këto aktivitete do të përqendrohen tek krijimi i mekanizmave digjitalë dhe të printuar të komunikimit me diasporën shqiptare, duke u hartuar një dosje thelbësore për aktivitetet mediatike, me qëllim angazhimin dhe përfshirjen e diasporës shqiptare. Gërshetimi i këtyre aktiviteteve do t'i shërbejë nevojave të diasporës për informim.

SHTYLLA 3 – PROGRAMI PËR KAPITALIN E DIASPORËS, LIDHJET E TYRE DHE RUAJTJEN E KULTURËS SHQIPTARE

AKTIVITETET 3.1 PROGRAMI “FELLOWS AND SCHOLARS”

Këto aktivitete do të përqendrohen tek përmirësimi i bashkëpunimit dhe shkëmbimit të akademikëve dhe profesionistëve të diasporës, duke promovuar mundësitë për talentet e reja nga Shqipëria për të studiuar jashtë vendit. Në këtë mënyrë, programi do të sigurojë lëvizjen e kapitalit njerëzor ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve/institucioneve partnere kyçe, duke sjellë përfitime reciproke.

AKTIVITETET 3.2 ÇMIMI “AMBASADOR I KOMBIT”

Këto aktivitete do të përqendrohen tek identifikimi i anëtarëve të diasporës së cilëve u duhet dhënë çmimi “Ambasador i Kombit”.

AKTIVITETET 3.3 “NGRIJE ZËRIN SHQIPËRI!”

Këto aktivitete do të përqendrohen tek të mësuarit e kulturës, trashëgimisë dhe gjuhës shqipe jashtë vendit, duke angazhuar dhe promovuar mësues të aftë, e duke promovuar kështu në mënyrë të vazhdueshme identitetin shqiptar.

AKTIVITETET 3.4 RRJETI I GRAVE TË DIASPORËS SHQIPTARE

Këto aktivitete do të përqendrohen tej ngritja dhe kurimi i Rrjetit të parë të Grave të Diasporës shqiptare. Për këtë arsye, do të hartohen termat e referencës, do të projektohet infrastruktura e rrjetit dhe do të përpilohen materialet e marketimit të tij. Po ashtu, do të organizohet edhe një aktivitet i madh përurues i rrjetit, që do të ketë në fokus diversitetin, barazinë dhe gjininë.

AKTIVITETET 3.5 JAVA KULTURORE

Këto aktivitete do të përqendrohen tek promovimi i kulturës, trashëgimisë dhe traditave shqiptare në nivel kombëtar dhe jashtë vendit, duke organizuar një javë kulturore me diasporën shqiptare.

SHTYLLA 4 – PËRFSHIRJA E DIASPORËS SHQIPTARE NË ZHVILLIMIN EKONOMIKO-SOCIAL TË VENDIT

AKTIVITETET 4.1 “CONNECT ALBANIA”

Këto aktivitete do të përqendrohen tek projekti “Connect Albania”, një program që bazohet tek referimi i investimeve dhe tek krijimi i vendeve të reja të punës.

AKTIVITETET 4.2 RRJETI GLOBAL I PROFESIONISTËVE SHQIPTARË

Këto aktivitete do të përqendrohen tek ngritja e një rrjeti profesional të diasporës, për të cilin do të përdoren të dhëna që do të jenë përpiluar gjatë aktiviteteve të mëparshme të kësaj strategjie për të arritur tek formalizimi i rrjetit, i cili do të përfshijë angazhime në sektorë specifikë dhe komponentë që i përkasin gjeneratës tjetër.

AKTIVITETET 4.3 PROGRAMI “ME ORIGJINË SHQIPTARE” – DIASPORA PROMOVON TURIZMIN DHE TREGTINË

Këto aktivitete do të përqendrohen tek promovimi i turizmit dhe tregtisë nga rrjetet e diasporës, duke plotësuar dosjet e ndryshme ministrore dhe duke përpiluar dhe përdorur një sërë mekanizmash digjitalë dhe “off-line” për tregtinë dhe turizmin.

AKTIVITETET 4.4 PROGRAMI “DIASPORA VEPRON”: REMITANCAT DHE SFIDAT E INVESTIMEVE

Këto aktivitete do të përqendrohen tek ato masa të strategjisë, që synojnë optimizimin e fluksit dhe ndikimit potencial të dërgesave në para (remitancave) nga diaspora shqiptare. Aktivitetet do të fokusohen tek avokacia me institucionet financiare, organizimin e konkurseve për start-up-et dhe hulumtime për remitancat.

SHTYLLA 5 – MONITORIMI DHE VLERËSIMI

AKTIVITETET 5.1 RISHIKIMI AFATMESËM

Rishikimi afatmesëm i procesit të zbatimit të Strategjisë është parashikuar të udhëhiqet nga një ekip me ekspertë të brendshëm dhe të jashtëm, të cilët do të vlerësojnë aktivitetet dhe punën e arritur në shtyllat e ndryshme me qëllim optimizimin më të mirë të mundshëm të zbatimit të strategjisë në vazhdimësi.

AKTIVITETET 5.2 RISHIKIMI I STRATEGJISË DHE HARTIMI I PLANIT TË VEPRIMIT 2025 – 2030

Ky do të jetë rishikimi madhor përfundimtar i strategjisë në bashkëpunim me auditues të huaj e që do të kurorëzohet me botimin e strategjisë së dytë për periudhën 2025 – 2030.

III. KRIJIMI I NJË KUADRI GJITHËPËRFSHIRËS INSTITUCIONAL

3.1 MARRËDHËNIET SHTETËRORE ME DIASPORËN

Pavarësisht dokumenteve të prodhuara nga politikat shtetërore, pak veprime konkrete janë ndërmarrë për ta bërë diasporën të ndjehet e mirëpritur në zhvillimin e vendit të tyre të origjinës. Në përpjekjet e tyre për të investuar, pjesëtarët e diasporës shpesh përballen me burokraci dhe probleme për shkak të korrupsionit. Strategjia parashikon një rol më të fortë të diasporës në të ardhmen, se ai që ka luajtur në të shkuarën. Synimet e strategjisë janë që të sjellë një fazë të re të marrëdhënieve shtet-diasporë, që mbështetet tek reciprociteti për ambicien për të ardhmen dhe objektivin që duhet arritur.

3.2 POLITIKAT SHTETËRORE DHE DIASPORA

Strategjia do të strukturojë mekanizmat publikë të politikës shtetërore për diasporën shqiptare në vend. Kjo do të fillojë me hartimin e manualeve praktikë në lidhje me çështjet e diasporës, të cilat do t’u jepen zyrtarëve që merren me zbatimin në praktikë të legjislacionit të diasporës. Strategjia do të identifikojë aktet ligjore dhe nënligjore që vihen në zbatim nga ato institucione që merren me çështje të diasporës dhe migracionit. Rëndësi do t’i jepet trajnimit dhe certifikimit të trupit diplomatik shqiptar për çështjet e migracionit, veçanërisht për të drejtat e komuniteteve të diasporës shqiptare.

Strukturat përgjegjëse do të vendosin kontakt të rregullt me Grupin Europian të Autoriteteve Vendore dhe Rajonale në Fushën e Imigracionit (ERLAI) me vendndodhje në Bruksel për të vlerësuar mundësitë për të mbështetur politikën e mbrojtjes së diasporës shqiptare në vendet pritëse të BE-së. Në këtë kuadër, do të inkurajohet intensifikimi i kontakteve të afërta ndërmjet organizatave shqiptare në diasporë dhe shoqatave të atyre vendeve për mbrojtjen e migracionit. Identifikimi i organizatave pritëse që merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të migrantëve në vendet do të konsiderohet një mekanizëm funksional në interes të komuniteteve shqiptare.

Nëpërmjet strategjisë do të kryhet një rivlerësim periodik i shërbimeve të tyre kundrejt diasporës. Më pas, në bazë të informacionit që do të mblidhet, do të hartohet raport vjetor për situatën konkrete të komuniteteve shqiptare, ku do të jepen edhe propozime për masat përkatëse që do të përmirësojnë asistencën ndaj tyre.

3.3 KOMITETI SHTETËROR PËR DIASPORËN

Komiteti Shtetëror për Diasporën është një organ konsultativ i Këshillit të Ministrave për bashkërendimin e politikave dhe aktiviteteve shtetërore në fushën e diasporës. Komiteti drejtohet nga Kryeministri dhe përbëhet nga Ministri i Punëve të Jashtme, Ministri i Brendshëm, Ministri i Financës dhe Ekonomisë, Ministri i Drejtësisë, Ministri i Arsimit, Rinisë dhe Sportit, Ministri i Kulturës, Ministri i Mjedisit dhe Turizmit, Ministri i Shtetit për Diasporën, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Kryetari i Akademisë së Shkencave dhe Drejtori i INSTAT-it.


Fusha e veprimtarisë së Komitetit përfshin:

1. përgatitjen e orientimeve për hartimin e politikave të reja aktive dhe përkufizimi i përparësive strategjike në fushën e diasporës;
2. propozime për mekanizma ligjorë dhe institucionalë për çështje që kanë të bëjnë me përmirësimin e pozitës së diasporës dhe me mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të pjesëtarëve të saj në vendet ku banojnë;
3. inkurajimin dhe krijimin e dialogut për zbatimin e strategjisë, politikave dhe legjislacionin në lidhje me komunitetet e diasporës;
4. bashkërendimin e aktiviteteve dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën;
5. mbështetje për strategjinë dhe monitorim të aktiviteteve të saj.

3.4 NËNKOMISIONI PARLAMENTAR PËR DIASPORËN DHE MIGRACIONIN

Nënkomisioni parlamentar për Diasporën dhe Migracionin vepron brenda Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Politikën e Jashtme. Përgjegjësitë e tij përfshijnë dhënien e propozimeve, shqyrtimin dhe monitorimin e zbatimit të legjislacionit shqiptar dhe politikave të vendit për diasporën dhe migracionin. Ky nënkomision do të ndihmojë në ndërtimin e kohezionit politik në Kuvend për çështje që kanë të bëjnë me diasporën.

3.5 AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS



Agjencia Kombëtare e Diasporës u krijua me një ligj të posaçëm në Shqipëri.¹³ Ajo ka përgjegjësi për zhvillimin dhe konsolidimin e bashkëpunimit institucional me diasporën, për mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të pjesëtarëve të diasporës, për ofrimin e asistencës në lidhje me ruajtjen e gjuhës amtare dhe të trashëgimisë kulturore, si edhe për promovimin e bashkëpunimit ekonomik ndërmjet vendit të origjinës dhe diasporës. Këshilli drejtues është organi vendimmarrës i Agjencisë.

3.6 FONDI SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN E DIASPORËS

Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës synon të ofrojë bashkëpunim dhe ndërveprim nëpërmjet inkurajimit të filantropisë dhe të investimeve të diasporës në mbështetje të zhvillimit të vendit. Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës do të bashkëpunojë me komunitetet dhe shoqatat/organizatat jashtë vendit që mund të kenë dëshirë të kanalizojnë kursimet e tyre drejt ndonjë investimi.

3.7 QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN

Qendra e Botimeve për Diasporën është përgjegjëse për botimin dhe shpërndarjen e teksteve të miratuara shkollore dhe librave të tjerë që do të ndihmojnë për të mësuar dhe për të ruajtur identitetin kombëtar të diasporës shqiptare. Krijimi, organizimi dhe funksionimi i Qendrës së Botimeve për Diasporën do të rregullohet me një vendim të Këshillit të Ministrave.

¹³ Ligji nr. 115/2017 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”.

3.8 KËSHILLI KOORDINUES I DIASPORËS

Marrëdhënia e re shtet-diasporë do të formalizohet dhe do të institucionalizohet me ngritjen e Këshillit Koordinues të Diasporës, një këshill përfaqësues të shtetit dhe të diasporës, që do të orientojë procesin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shtetërore dhe diasporës shqiptare.

1. Këshilli do të jetë një strukturë ndërinstitucionale për angazhimin e diasporës dhe emigrantëve. Ai do të përbëhet nga partnerët kryesorë institucionalë të shtetit shqiptar dhe të diasporës.
2. Këshilli i Diasporës do të mbështesë krijimin e një rrjeti të organizuar komunitetesh shqiptarësh në vendet pritëse dhe ato të origjinës.
3. Organizatat e Diasporës do të përcaktojnë synimet e tyre, strategjitë, funksionet dhe fushat e veprimit, sipas burimeve në dispozicion, opsioneve ligjore dhe institucionale në vendet pritëse.
4. Rëndësia e organizatave të diasporës është njohur dhe pranuar nga institucionet politike kombëtare dhe ndërkombëtare, si për shembull nga Komisioni Europian, Këshilli i Europës dhe qeveritë e vendeve pritëse. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, institucionet dhe politikanët e nivelit të lartë i falënderojnë publikisht organizatat shqiptaro-amerikane për punën që ato bëjnë.

IV. BUXHETI DHE KOSTOT

Meqenëse ishte hera e parë që Ministri i Shtetit për Diasporën u bë pjesë e strukturës së qeverisë, kostot u parashikuan paraprakisht për vitin 2018, që të bëhej e mundur zbatimi i strategjisë.

Në Planin e Veprimit për periudhën 2018-2024 janë identifikuar masa dhe kosto përkatëse për zbatim gjatë vitit 2018.

Financimi i këtyre masave shumëdisiplinore do të mbulohen kryesisht nga programet buxhetore të institucioneve zbatuese të kësaj Strategji. Kostot e parashikuara paraprakisht për vitin 2018 arrijnë shifrën 130.000.000 lekë, si më poshtë vijon:

- | | |
|---|------------------|
| - Agjencia Kombëtare e Diasporës | 60 milionë lekë; |
| - Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës | 50 milionë lekë; |
| - Qendra e Botimeve për Diasporën | 20 milionë lekë. |

Ato i referohen kryesisht krijimit funksional, operacional dhe administrativ të strukturave të reja shtetërore. Përlllogaritjet janë në përputhje me Ligjin Nr. të datës 28.12.2017, si edhe me akte ligjore dhe nënligjore të tjera në fuqi. Ndërsa kostot e tjera do të mbulohen nga buxhetet e institucioneve përgjegjëse dhe nga donatorët.

Do të ngrihet një grup i posaçëm pune nën drejtimin e Ministrit të Shtetit për Diasporën, i cili do të përcaktojë dhe shtjellojë kostot e Planit të Veprimit për periudhën 2019-2024.

Ky grup pune do të përbëhet nga përfaqësues të të gjitha institucioneve që kanë përgjegjësi për zbatimin e kësaj strategjie dhe planit të saj të veprimit. Afati kohor për përfundimin e planit të veprimit 2019-2024 do të jetë një vit që nga miratimi i kësaj strategjie. Grupi i punës do të ngrihet pas hyrjes në fuqi të vendimit që do të miratojë Strategjinë Kombëtare për Diasporën 2018-2024 dhe Planin e saj të Veprimit.

Do të veprohet si më poshtë vijon për të llogaritur kostot e veprimtarive kryesore që do të mbulohen nga buxheti i shtetit dhe donatorët:

1. Llogaritja e kostove të burimeve njerëzore mbështetet tek koha që është parashikuar për kryerjen e aktiviteteve dhe një pagë mesatare ditore e një kategorie të caktuar nëpunësi civil.
2. Për llogaritjen e shpenzimeve për shërbime të ndryshme merret parasysh kostoja e shërbimeve të institucioneve përkatëse, duke u bazuar tek standardet e miratuara.
3. Kostoja e aktiviteteve për hartimin dhe rishikimin e legjislacionit, për monitorimin dhe funksionimin e strukturave të përhershme, etj. llogaritet duke marrë në konsideratë kostot që do të jenë në vijimësi, si për shembull pagat, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, ekspertizën e huaj (kur është parashikuar në plan) dhe mjete të tjera konsumi.
4. Ndërsa për “aktivitete specifike” apo iniciativa të ngjashme llogaritja bazohet kryesisht tek natyra e aktiviteteve dhe kostot që përcakton tregu për këto lloj shërbimesh.

Sa u përket trajnimeve, për shpenzimet është marrë parasysh kostoja e trajnimit për person, ndërsa njësi matëse janë konsideruar kostot e Shkollës Shqiptare të Administratës Publike dhe/apo kosto të tjera nga trajnime të ngjashme në të shkuarën. Për aktivitete për të cilat informacioni nuk është i plotë, ose është ndjekur metoda analitike e vlerësimit, ose janë gjetur kostot e aktiviteteve të përafërta që janë kryer gjatë zbatimit të strategjisë së mëparshme për vitet 2011-2015, ose është marrë në konsideratë kostoja e produkteve të ngjashme në PBA.

Për Strategjinë Kombëtare 2018-2024 dhe Planin e saj të Veprimit, përfundimet për buxhetin do të nxirren nga Komiteti Shtetëror për Diasporën, i cili u krijua me VKM-në Nr. 690 të datës 22.11.2017 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Komitetit Shtetëror për Diasporën”.

V. ZBATIMI DHE MONITORIMI

Kjo pjesë e strategjisë, e cila përshkruan një sërë aktiviteteve konkrete që do të sigurojnë qëndrueshmërinë e saj, është hartuar duke vlerësuar dhe kuptuar diasporën shqiptare, në përputhje si me trajektorët e saj historike dhe bashkëkohëse, ashtu edhe me objektivat e zhvillimit të vendit dhe angazhimin e diasporës në to deri në vitin 2024. Janë hartuar me synimin që:

- të jenë realiste, të arritshme dhe të shkallëzueshme duke pasur parasysh buxhetet e institucioneve dhe mbështetjen që pritet të vijë nga donatorët;
- të trajtojnë objektivat e zhvillimit social, ekonomik dhe kulturor të Shqipërisë;
- të ofrojnë një vlerë të shtuar për strukturat ekzistuese të angazhimit të diasporës, duke hapur edhe fusha të reja përfshirjeje për shqiptarët jashtë vendit;
- të inkurajojnë zhvillimin e një marrëdhënieje krenarie dhe besimi ndërmjet qeverisë së Shqipërisë dhe diasporës.

5.1 ANGAZHIMET KRYESORE PËR SECILËN PREJ SHTYLLAVE PËR PERIUDHËN 2018-2024

Meqenëse kuadri kohor i kësaj politike është për një periudhë prej 6 vjetësh, për programin thelbësor të angazhimeve që ajo ndërmerr, janë përfshirë Diaspora shqiptare, organizatat ndërkombëtare dhe ekspertët e diasporës. Kjo është arsyeja që programi është menduar të ketë dy cikle prej tre vjetësh secili për periudhën 2018-2021, me një rishikim të angazhimeve në vitin 2021 për të riorientuar në këtë mënyrë nevojat apo për të vlerësuar mundësitë e tjera që mund të kenë dalë deri atëherë. Do të ishte kritike që këto angazhime të përfshiheshin si një kuadër monitorimi dhe vlerësimi, në mënyrë që të sigurohet sukcesi i iniciativave dhe i vetë politikës. Kjo do të sjellë një rishikim afatmesëm për të çuar më pas në vlerësimin e aktiviteteve në vitin 2021 me synim përforcimin e aktiviteteve për periudhën 2022-2024.

Roli i qeverisë për arritjen e rezultateve sipas shtyllave, 2018-2021

Shtylla 1 – Qeverisja dhe Menaxhimi i Njohurive	
I.	Krijimi i një qasjeje të plotë të qeverisë për angazhimin e diasporës.
II.	Fuqizimi i portofolit të Ministrit të Shtetit dhe aparatit institucional për të përmirësuar angazhimin dhe përfshirjen e diasporës.
III.	Ngritja e një grupi pune me disa nivele për ndjekjen e zbatimit të strategjisë; për t’u rishikuar me zhvillimin e strategjisë.
IV.	Krijimi i një Këshilli Koordinues të Diasporës.

Shtylla 2 – Avancimi i Programit të të Drejtave Politike dhe Sociale të Diasporës	
I.	Përmirësimi i shërbimeve mbështetëse të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për pjesëtarët vulnerabël të diasporës shqiptare.
II.	Avokimi në mënyrë aktive si në nivel komunal, ashtu edhe në nivel diplomatik për diasporën shqiptare për të çuar përpara të drejtat e tyre politike dhe sociale.
III.	Efektivitet dhe promovim gjithnjë e në rritje i organizatave të diasporës shqiptare jashtë vendit; diasporës shqiptare i ofrohen mundësi për t’u konsultuar me qeverinë e Shqipërisë.
IV.	Zhvillimi i një komunikimi dhe angazhimi sistematik me mediat për të bërë më të lehtë mbështetjen e shtuar për diasporën shqiptare.

Shtylla 3 – Programi për Kapitalin e Diasporës, Lidhjet e tyre dhe Ruajtjen e Kulturës shqiptare	
I.	Promovimi i vazhdueshëm i kulturës dhe trashëgimisë shqiptare jashtë vendit.
II.	Krijimi dhe qëndrueshmëria e platformave shumë-mediatike për të marrë dhe përfshirë interesat e ndryshme të diasporës shqiptare.
III.	Fuqizimi i promovimit dhe i mësimin të gjuhës shqipe jashtë vendit.
IV.	Fuqizimi i kontributeve të drejtpërdrejta të kapitalit njerëzor të diasporës në procesin e zhvillimit të vendit.

Shtylla 4 - Përfshirja e Diasporës në Programin e Zhvillimit ekonomik-social të Shqipërisë

I.	Sigurohet vazhdimësia e kërkimit shkencor, dialogut dhe shpërndarja e analizave në kohë reale për klimën e biznesit dhe mundësitë për investime në Shqipëri.
II.	Krijohen një sërë produktesh për investime nga diaspora ose për “kulturën e investimeve”, duke përfshirë produkte individuale ose kolektive.
III.	Ofrohet avokaci dhe mbështetje për përdorimin dhe transferimin më efektiv të remitancave (dërgesave në para).
IV.	Krijohet infrastruktura në rrjet për të mundësuar aplikimin e kapitaleve të ndryshme të diasporës Brenda vetë diasporës për zhvillimin ekonomik-social të vendit.

Programi shtesë i angazhimeve për periudhën 2022 – 2024

Në Strategji rekomandohet që në vitin 2021 të ketë një rishikim strategjik të këtij dokumenti me synim vlerësimin e potencialeve të reja për angazhimin dhe përfshirjen e diasporës. Për këtë arsye janë menduar disa aktivitete të tjera konsultative, si bazë për angazhimet kryesore të parashikuara gjatë periudhës trevjeçare 2022 – 2024. Parashikohet që qeveria e Shqipërisë të vijojë me:

- fuqizimin e marrëdhënies me diasporën dhe përdorimin e kontributeve të saj për zhvillimin e vendit;
- idetë të reja që do të lindin nga përfshirja konkrete dhe sistematike e diasporës;
- përgatitja e planeve dhe iniciativave fazën e dytë të strategjisë;
- rezultate konkrete që tregojnë rritjen e kontributit të diasporës gjatë periudhës afatmesme.

5.2 DIMENSIONET FUNKSIONALE TË ZHVILLIMIT DHE TË ZBATIMIT TË STRATEGJISË

Duhet të merren parasysh një sërë masash ose dimensionesh praktike, me qëllim rritjen e nivelit të zbatueshmërisë dhe të suksesit të kësaj strategjie. Për këtë arsye, është e domosdoshme që këto dimensione të përfshihen në kuadrin e strukturuar për të arritur qasjen e plotë që avokohet nga kjo strategji. Këto çështje duhet të merren parasysh së bashku me strategjinë nga:

- një sërë departamentesh qeveritare që kanë të bëjnë me sigurinë dhe qëndrueshmërinë e kësaj strategjie;
- detyrimet procedurale të shërbimit civil sipas interesave të këtij dokumenti politik;
- kapacitetet drejtuese dhe menaxhuese të të gjitha departamenteve që kërkojnë të arrijnë performancën optimale të kësaj strategjie.

Për këtë arsye, në Planin e Veprimit të Strategjisë janë shtjelluar elementë praktikë që sjellin performancën e saj optimale. Kapacitetet qendrore që janë marrë parasysh janë:

- përcaktimi i treguesve të cilësisë;

- kapacitetet menaxhuese dhe zhvillimi i kapaciteteve;
- angazhimi dhe komunikimi;
- bashkërendimi dhe partneriteti ndërqeveritar;
- menaxhimi financiar dhe vlerësimi;
- arritja e partneriteteve strategjike me komunitetin e donatorëve;
- komponentët e administrimit.

5.3 ZBATIMI I STRATEGJISË

Format më të suksesshme të strategjive të angazhimit të diasporës janë ato që operojnë Brenda një modeli hibrid publik-privat, që sjell edhe një rol lehtësues pëe qeverinë. Kjo shpesh sjell lidhjet e dokumenteve të politikës me një sërë projektsh dhe programesh, të cilat, sipas terminologjisë së IOM-it, **angazhojnë, lejojnë dhe fuqizojnë** komunitetet jashtë vendit për t'u bërë agjentë të zhvillimit në vendet e tyre të origjinës.

Është arritur konsensus për projekte dhe iniciativa të ndryshme që do të zhvillohen gjatë kohëzgjatjes së kësaj strategjie, megjithatë disa elementë të rëndësishëm kushtetues në kuadrin zbatues do të ndihmojnë për të rritur gjasat e suksesit të saj, përfshirë:

- krijimin dhe vendosjen e një kulture organizative dhe operacionale sipas organizimit në qeveri dhe buxhetit përkatës (shih Shtojcën III);
- krijimin e një kuadri angazhues, të aksesueshëm dhe komunikimi;
- përcaktimin e burimeve profesionale dhe njerëzore dhe koha për t'u angazhuar me diasporën shqiptare;
- krijimin e një forme sistematike matriceje për rishikimin operacional dhe për performancën.

5.4 KRIJIMI I NJË KULTURE ORGANIZATIVE DHE OPERACIONALE

Në hartimin e kësaj strategjie qeveria e Shqipërisë njih rolin qendror të Diasporës shqiptare për zhvillimin e vendit. Brenda strukturave ekzistuese është e domosdoshme të vijojë mbështetja për rritjen e Ministrit të Shtetit për Diasporën nëpërmjet pjesëmarrjes ndërqeveritare, synimi i vetëm i të cilëve është zbatimi i suksesshëm i kësaj politike. Duke pasur parasysh pasojat e gjera që sjell përfshirja e diasporës në fushat sociale, ekonomike dhe kulturore, është e rëndësishme që të ketë bashkëpunim dhe lidhje ndërmjet të gjitha fushave që prek kjo strategji.

Përtej kapaciteteve operacionale, Ministria e Shtetit dhe aparati i vet institucional do të lehtësojë kulturën operacionale dhe organizative të bazuar tek:

- Ofrim shërbimesh që synon arritjen e rezultateve;
- Vendosja në dispozicion e personelit profesional dhe të trajnuar (trajnimi është përfshirë në planin e veprimit të strategjisë);
- Shërbime bashkërenduese me një sërë aktorësh/iniciativash;
- Mbështetje në vazhdimësi për rrjetin e organizatave të diasporës shqiptare jashtë vendit;
- Përfshirje aktive e shoqërisë civile tek zbatimi i strategjisë;
- Bashkëpunim me sektorin privat në Shqipëri për zbatimin e strategjisë;
- Program i rregullt dhe efikas komunikimi dhe sensibilizimi.

Me qëllim marrjen në vazhdimësi të besimit nga diaspora, financimi i ciklit të hershëm të strategjisë duhet të përcaktohet në buxhetin e qeverisë, pasi në këtë formë ndihmohet jo vetëm prezantimi, por edhe vazhdimësia e

fazave të para të strategjisë. Ky hap do të rriste edhe besimin e donatorëve për angazhimin e qeverisë në lidhje me strategjinë dhe suksesin e saj.

5.5 MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Si me çdo strategji, është e rëndësishme që të përcaktohen kriteret e rrepta monitorimi dhe vlerësimi, duke pasur parasysh shpenzimin e fondeve publike dhe shpërndarjen e burimeve të ndryshme nga qeveria dhe donatorët, që bëjnë të mundur dhënien e rezultateve të kësaj strategjie. Megjithatë, sistemet e tilla monitorimi duhen hartuar si **“mekanizëm përmirësimi dhe ecurie dhe jo si armë për të hedhur akuza ndaj dikujt.”**¹⁴ Për këtë arsye, brenda kësaj strategjie janë përfshirë disa pika të rëndësishme si pjesë përbërëse e objektivave dhe vizionit të strategjisë. Përveç tyre, treguesit kyç të performancës që janë nxjerrë nga të kuptuarit në nivel bazë të strategjisë do të bëjnë të mundur një hap të dytë vlerësimi.

Në përgjithësi, ne mund të krijojmë korniza vlerësuese dhe mekanizma për zhvillimin e vazhdueshëm institucional në të gjithë Planin e Veprimit, të cilat do të përmirësojnë kapacitetet tona për të formësuar korniza efektive monitorimi dhe vlerësimi (shih Shtojcën I).

5.6 AUDITIMI DHE TRANSPARENCA

Për zbatimin e suksesshëm të kësaj Strategjie, është e domosdoshme që të gjithë aktorët përkatës të bëjnë të mundur mbledhjen e efikase të të dhënave, në mënyrë që ecuria e saj të mund të verifikohet, auditohet dhe për të të raportohet në mënyrë të pavarur dhe transparente.

Rishikimi final i Strategjisë do të kryhet në përfundim të vetë Strategjisë dhe do të përfshijë edhe një rishikim sistematik të kuadrit monitorues dhe vlerësues me qëllim përmirësimin e nevojave të Strategjisë dhe ripërtëritjen e saj në të ardhmen. Është e domosdoshme që ky rishikim të përfshijë edhe konsultim nga jashtë, siç edhe është diskutuar në të shkuarën.

PËRFUNDIME

Strategjia Kombëtare për Diasporën dhe Plani i saj i Veprimit 2018 - 2024 përbëjnë kuadrin përrues të shtetit shqiptar për të përmirësuar bashkëpunimin dhe marrëdhënien ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe Diasporës shqiptare. Dokumenti i Strategjisë është hapi i parë në krijimin e kulturës për angazhimin dhe përfshirjen e Diasporës, në mënyrë që kjo e fundit të bëhet faktor pozitiv dhe përcaktues i zhvillimit të vendit. Strategjia ofrohet në frymën e bashkëpunimit, bashkë me një sërë drejtimesh dhe aktiviteteve të hartuara për të pasqyruar realitetin aktual jo vetëm të Diasporës shqiptare, por edhe të nevojave dhe potencialit të saj.

Zbatimi i suksesshëm i kësaj Strategjie do të përcaktohet nga udhëheqja dhe partneriteti i aktorëve kryesorë, të cilët mund ta çojnë përpara suksesin e saj. Brenda një kuadri gjithëpërfshirës dhe transparent, Strategjia mund të ofrojë asistencë të vlefshme si për thellimin e lidhjeve të Diasporës shqiptare me atdheun, ashtu edhe për përcaktimin e tyre si partnerë kyç për zhvillimin e Shqipërisë, qofshin ata jashtë apo brenda vendit.

¹⁴ Gibril Faal, *Moldovan Diaspora Strategy 2025: Towards Productive Actual and Virtual Return to Moldova* ([Shënim i përkthyesit për titullin e artikullit: *Strategjia e Moldavisë për Diasporën 2025: Drejt Kthimit Produktiv, Aktual dhe Virtual në Moldavi*)

SHTOJCA I – PLANI I VEPRIMIT: STRATEGJIA PËR DIASPORËN SHQIPTARE, 2018 – 2024
(BASHKËLIDHUR MË VETE)

SHTOJCA II – LISTA E AKTIVITETEVE PËR ÇDO MASË QË PREJ STRATEGJISË SË PARË (BASHKËLIDHUR
MË VETE)

SHTOJCA III – UDHËRRËFYESI I STRUKTURËS SË QEVERISJES (BASHKËLIDHUR MË VETE)

PLANI I VEPRIMIT PËR STRATEGJINË KOMBËTARE PËR DIASPORËN 2018 – 2023

LISTA E AKRONIMEVE

AKD	Agjencia Kombëtare për Diasporën
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
ASHZHI	Agjencia Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve
BSH	Banka e Shqipërisë
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DBESH	Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri
DSHQ	Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare
FSHZHD	Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës
GNIP	Grupi Ndërinstitucional i Punës
INSTAT	Instituti i Statistikave
IKSSH	Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
ISSH	Instituti i Sigurimeve Shoqërore
MASR	Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë
MB	Ministria e Brendshme

MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MDIS	Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike në Kosovë
MFE	Ministria e Financës dhe Ekonomisë
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MK	Ministria e Kulturës
MSHD	Ministri i Shtetit për Diasporën
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MSHS	Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
QBD	Qendra e Botimeve për Diasporën
QSH	Qeveria e Shqipërisë
SHSHAP	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike

Objektivi Specifik A: Zhvillimi i Kulturës për Angazhimin me Diasporën Shqiptare

Treguesit e Rezultatit/-eve: Zhvillimi i kuadrit ligjor kombëtar për angazhimin e diasporës; pasja e niveleve adekuate të personelit për të siguruar zbatimin efikas dhe për të koordinuar angazhimin e diasporës; numri i partneriteteve të reja me aktorët publikë dhe privatë për zhvillimin e kulturës së angazhimit me diasporën shqiptare; Ngritja e kapaciteteve institucionale;

Nr.	Nën-objektivi	Veprimet që do të ndërmerren	Afati Kohor	Burimet Financiare në mijëra Lekë Shqiptare	Njësitë Përgjegjëse		Rezultatet & Treguesit	
					Agjencia Udhëheqëse	Së bashku me		
1.0	Qeverisja dhe Menaxhimi i Njohurive	1.1 Krijimi i një Kulture Administrative 1.1.1 Ngritja e të gjithë aparatit të nevojshëm zbatues, duke përfshirë: Agjencinë Kombëtare për Diasporën, Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, Qendrën Botuese, Komisionin Shtetëror, Këshillin Koordinues për Diasporën.	2019 - 2024	147,488	MSHD	MFE GNIP	Rishikimi dhe identifikimi i bashkëbiseduesve për angazhimin e diasporës; Ngritja e aparatit të ri institucional.	Numri i institucioneve të ngritura për të siguruar zotimin e Shqipërisë për Angazhimin me Diasporën; Numri i institucioneve të angazhuara për të siguruar ngritjen e të gjitha institucioneve të planifikuara.
		1.1.2 Hartimi i Planit të Veprimit për Zbatimin e Strategjisë	2019	1,875	MSHD	MFE Donatorët	Hartimi i Planit Vjetor të Punës për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën.	Numri i programeve/aktiviteteve të planifikuara për t'u zhvilluar çdo vit; Përmirësimi i kuadrit strategjik për angazhimin e diasporës.
		1.1.3 Akordimi i burimeve të nevojshme për aparatit e ri (Burimet Njerëzore dhe Buxheti Operacional)	2019 - 2024	24,654	MSHD	MEPJ Donatorë	Hartimi dhe ngritja e Sistemeve të Përgjegjësive;	Numri i personelit të punësuar; Numri i rekomandimeve specifike të miratuara në përputhje me zbatimin e këtij Plani Veprimi, për të siguruar një shkallë më të lartë përgjegjësie dhe zbatimin e suksesshëm të tij.

	1.1.4 Rishikimi i legjislacionit që lidhet me Angazhimin e Diasporës	2020 - 2021	825	MSHD	GNIP	Një reformë gjithëpërfshirëse ligjore e legjislacionit shqiptar që lidhet me angazhimin e diasporës, së bashku me rekomandimet për ndryshimet ligjore nga ministritë e linjës.	Numri i ndryshimeve ligjore të miratuara çdo vit për të siguruar zotimet e Shqipërisë në angazhimin e diasporën.
	1.1.5 Hartimi dhe shpallja e Reformës/Akteve të Reja që do të mbështesin angazhimin e diasporës.	2019 - 2024	2,736	MSHD	Të gjitha Ministritë	Rishikime lidhur me ndikimin e reformës/akteve kryesore ligjore që lidhen me angazhimin e diasporës.	Numri i takimeve të zhvilluara për rishikimin; numri i ndryshimeve specifike ligjore të miratuara në përputhje me zbatimin e këtij Plani Veprimi, për të siguruar ekzekutimin e suksesshëm të strategjisë kombëtare.
	1.1.6 Zhvillimi i kurrikulës/programit të trajnimit TT (Trajnimit të Trajnuesve), duke përfshirë materialin trajnues, ngritjen e fondeve dhe zhvillimin dhe zbatimin e projektit, me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike për personelin e Agjencisë Kombëtare për Diasporën, Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Zyrën e MSHD-së për mbajtjen e trajnimeve TT.	2019	8,357.72 5	MSHD	SHSHAP AKD FSHZHD	Mbështetja dhe zgjerimi i kapaciteteve të strukturave të reja të krijuara për diasporën.	<ul style="list-style-type: none"> - Zhvillimi i kurrikulës trajnuese duke marrë parasysh edhe faktorin gjinor, me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, lidhur me ngritjen e fondeve, si dhe me zhvillimin dhe zbatimin e projekteve; - # i trajnimeve të zhvilluara TT (Trajnimi i Trajnuesve) lidhur me ngritjen e fondeve, zhvillimin dhe zbatimin e projektit dhe # e pjesëmarrësve; - % e zyrtarëve trajnues të trajnuar, edhe mbi baza gjinore, të cilët arrijnë rezultatin 80 për qind ose më të lartë në testimet pas trajnimit; - numri i ekspertëve të dislokuar për këshillime gjatë trajnimit në procesin e punës.
	1.1.7 Zhvillimi i mekanizmave ndër-qeveritarë koordinues të fazës së hershme (Grupet e Punës)	2019 - 2024	3,420	MSHD	MFE MEPJ MASR MK MTM	Ngritja e një mekanizmi ndër-qeveritar për angazhimin me diasporën.	Numri i institucioneve të përfshira në mekanizmin ndër-qeveritar; numri i rregulloreve; rekomandimet dhe dokumentet e përgatitura; numri i takimeve të zhvilluara gjatë vitit.

		1.1.8 Rishikimi i Mekanizmit Koordinues në vitin 2020	2020	760	MSHD	GNIP Donatorët	Rishikimi i mekanizmit të ngritur ndër-qeveritar për angazhimin me diasporën.	Nevoja specifike për fuqizimin e kapaciteteve institucionale të identifikuara dhe zbatimi i ndryshimeve adekuate organizative.
		1.1.9 Hartimi i dokumentit të ri të kulturës administrative (2021 – 2024) që përcakton qeverisjen e re, kulturën organizative dhe operacionale	2020	760	MSHD Donator	MFE MEPJ MASR MK MTM	Konsultimet ndër-institucionale do të zhvillohen për të hartuar dokumentin për kulturën e re administrative.	Mbështetja dhe zgjerimi i kapaciteteve të strukturave të reja të krijuara për diasporën; përmirësimi i kuadrit strategjik për angazhimin e diasporës.
		1.2 Ngritja e Partneriteteve me Komunitetin e Donatorëve						
		1.2.1 Rishikim Studimor “Potencialet e Angazhimit të Diasporës Shqiptare dhe Mbështetjes së Donatorëve”	2020	1,100	MSHD	MEPJ	Do të botohet një raport lidhur me potencialin e Angazhimit të Diasporës Shqiptare; identifikimi i partnerëve/donatorëve kryesorë me temën e diasporës; sektorët me potencialin më të madh përse i përket bashkëpunimit; rezultatet dhe rekomandimet do të ndahen me palët e interesuara.	Deri në ç’masë janë miratuar rekomandimet e raportit nga ana e institucioneve për të lehtësuar bisedimin me partnerët/donatorët për zbatimin me sukses të strategjisë.
		1.2.2 Zhvillimi i Objektivave të Mbështetjes së Donatorëve	2019	228	FSHZHD	MSHD AKD	Rishikimi i hartës aktuale të donatorëve në Shqipëri; identifikimi i donatorëve potencialë nga sektorët publikë dhe privatë; numri i projekteve të mbështetura, investimet financiare, mbështetja e burimeve njerëzore.	Nevojat specifike për fuqizimin e kapaciteteve institucionale identifikohen gjatë rishikimit; duhet të zbatohen ndryshimet organizative.
		1.2.3 Zhvillimi i Indeksit të Perspektivës së Donatorëve	2019	412.5	FSHZHD	MSHD	Identifikohet numri i donatorëve nga sektorët publikë dhe privatë; Zhvillimi i Indeksit të Perspektivës së Donatorëve.	Deri në ç’masë është miratuar nga institucionet zhvillimi i Indeksit të Perspektivës së Donatorëve, në mënyrë që të lehtësojë bisedimin me partnerët/donatorët për të zbatuar me sukses strategjinë.

	1.2.4 Përfshirja e Komunitetit të Donatorëve me Samitet dhe veprimtaritë e tjera përkatëse për angazhimin e diasporës.	2019-2024	4,800	AKD	MSHD FSHZHD MEPJ MFE	Numri i takimeve në të cilat u përfshinë donatorët; numri i partneriteteve të ngritura me donatorët; numri i koordinimeve me projekte të zbatuara nga donatorët.	Deri në ç'masë institucionet ftojnë/përfshijnë donatorët përkatës lidhur me takimet dhe koordinimet për Angazhimin e Diasporës.
	1.2.5 Seritë e Dialogut me Donatorët: Një seri tryezash të rrumbullakëta të zhvilluara dy herë në vit me Komunitetin e Donatorëve lidhur me Zbatimin e Strategjisë.	2020-2024	5,000	MSHD	AKD MEPJ MFE	Numri i tryezave të rrumbullakëta vjetore me komunitetin e donatorëve.	Njohuri në kohë reale të Donatorëve lidhur me fushat e fokusit të tyre (donatorëve); sigurimi i fondeve të jashtme për të mbështetur akordimin e burimeve të brendshme.
	1.2.6 Zhvillimi i Strukturës së Menaxhimit të Marrëdhënieve me Donatorët (duke përfshirë edhe oficerin kryesor të kontaktit nga MSHD-ja, komunikimet/përmbledhjet për donatorët, rivlerësimi i rishikimit studimor).	2020	912	MSHD	AKD MEPJ MFE	Numri i takimeve të zhvilluara me donatorë të veçantë, të identifikuar gjatë rishikimit studimor; numri i partneriteteve të ngritura nga ana e oficerit kryesor ndërlidhës të MSHD-së; numri i projekteve të mbështetura/të zbatuara.	Ngritja e Sistemit të Menaxhimit të Marrëdhënieve me Donatorët.
	1.3 Diplomacia për Diasporën						
	1.3.1 Vlerësimi i nevojës për një prani të re diplomatike apo konsullore përfaqësimi në vendet me një numër të konsiderueshëm komunitetesh shqiptare.	2019	990	MEPJ	MSHD Donatorët	Një nivel i rritur i njohurive të specializuara për angazhimin e diasporës nga ana e Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe aparatit të ri; një promovim më i madh i strategjisë përmes rrjeteve të ambasadave/konsullatave; një ndërgjegjësim më i madh rajonal dhe global lidhur me strategjinë.	Ekzistenca e vetë programit të trajnimit; numri i moduleve të trajnimit që janë përgatitur dhe përafuar me këtë program kombëtar; numri i zyrtarëve të Qeverisë së Shqipërisë të trajnuar çdo vit me anën e këtij programi.
	1.3.2 Zhvillimi i një pakete të re instrumentesh diplomatike për diasporën për nevojat e diplomatëve shqiptarë.	2020	412	MEPJ	MSHD	Botimi i Paketës së Instrumenteve për Diplomacinë për Diasporën; për t'u siguruar që të gjithë diplomatët shqiptarë zbatojnë	Deri në ç'masë i kanë miratuar diplomatët shqiptarë rekomandimet; aplikimi i paketës së re të instrumenteve të siguruar; numri i

							në mënyrë efikase atë pjesë të strategjisë që lidhet me kryerjen e detyrave të tyre.	trajnesve të angazhuar me diplomatët.
	1.3.3 Ngritja e komisioneve konsultative bilaterale të nivelit të lartë me vendet pritëse për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve të diasporës shqiptare.	2019-2024	8,316	MEPJ	MSHD		Ngritja e komisionit konsultativ bilateral të nivelit të lartë.	Numri i institucioneve që marrin pjesë; numri i takimeve të zhvilluara; numri i çështjeve të adresuara për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve të diasporës shqiptare.
	1.3.4 Fuqizimi i marrëdhënieve diplomatike me vendet e një rëndësie të veçantë, për shkak të numrit të konsiderueshëm të diasporës shqiptare që banon atje.	2019-2024	4,158	MEPJ	MSHD		Marrëveshje Bilaterale me vendet kryesore ku banon diaspora shqiptare (p.sh. Italinë, Greqinë);	Numri i shtetasve shqiptarë që përfitojnë nga marrëveshjet e reja; numri i çështjeve të adresuara si rezultat i marrëveshjeve; numri i programeve të përcaktuara si pasojë e tyre.
	1.3.5 Hartimi i një Plani të përbashkët Veprimi me shtetin e Kosovës në fushën e marrëdhënieve me diasporën.	2019-2020	990	MSHD	GNIP MDIS		Hartimi i një Plani të përbashkët Veprimi me shtetin e Kosovës.	Numri i programeve/aktiviteteve të planifikuara për t'u ekzekutuar së bashku; numri i çështjeve të ngritura dhe të adresuara si pjesë e planit të përbashkët; numri i programeve/aktiviteteve të përbashkëta që janë kryer.
	1.3.6 Vendosja e kontakteve të rregullta me Grupin Evropian të Autoriteteve Rajonale dhe Lokale në fushën e Imigrimit (ERLAI), me qendër në Bruksel, me qëllim që të vlerësohen mundësitë për mbështetjen e politikave mbrojtëse të komuniteteve të diasporës në vendet pritëse të BE-së.	2021-2024	5,544	MEPJ	MSHD		Vendoset bashkëpunimi me Grupin Evropian të Autoriteteve Rajonale dhe Lokale në Fushën e Imigrimit (ERLAI).	Numri i praktikave të mira ndërkombëtare për sigurimin e mbështetjes së politikave mbrojtëse të komuniteteve të diasporës në vendet pritëse të BE-së; numri i çështjeve të adresuara apo shërbimeve, si rezultat i vendosjes së bashkëpunimit me këtë grup (ERLAI).
	1.3.7 Puna për ngritjen e një kuadri diplomatik për mbështetjen e aktiviteteve të rekomanduara të këtij plani veprimi në fusha të tilla, si: promovimi i kulturës, arsimit, trashëgimisë, tregtisë shqiptare, e kështu me radhë	2020-2024	6,930	MEPJ	MSHD		Ngritja e grupit koordinues të kohortës diplomatike që do të sigurojë përfshirjen e planit të veprimit dhe tematikave kryesore të tij që lidhen me komunitetet jashtë vendit.	Numri i takimeve koordinuese dhe konsultative të zhvilluara mes grupeve diplomatike; numri i raporteve të botuara.

	1.4 Qendër Hulumtimi dhe Trajnimi për Diasporën (2020 – 2024)						
		4.4.8 Përgatitja e Vitit të Turizmit të Diasporës Shqiptare	2022	5,412	MTM		Përgatitja e ofertës vjetore të turizmit.	Përgatitja e ofertës vjetore të turizmit; të gjitha institucionet koordinohen në ofertë.
		4.4.9 Përgatitja e Panairit Tregtar të Diasporës	2022	6,000	MFE	ASHZHI	Përgatitja e Panairit Tregtar të Diasporës.	Numri i mbajtur i Panaireve Tregtare të Diasporës; numri i pjesëmarrësve në këto panaire; numri i bizneseve të diasporës që marrin pjesë në këto panaire.
		4.4.10 Zhvillimi i nismës “Me origjinë lokale” për të rritur zhvillimin vendor	2022-2023	37,152	MBZHR	MSHD MFE ASHZHI Donatorët	Lidhja e produkteve vendore me tregun e diasporës.	Numri i punësimeve të krijuara; numri i bizneseve eksportuese.
		4.4.11 Kryerja e një rishikimi të zgjeruar të nismës “Me origjinë shqiptare”	2024	760	MFE	MSHD Donatorët	Kryerja e një rishikimi të zgjeruar të programit; identifikimi i konsultimeve të brendshme dhe të jashtme që do të ndihmojnë me rishikimin; adresimi i nevojave dhe mundësive për shkallëzimin e programit.	Numri i rekomandimeve/mekanizma ve të identifikuar për të përmirësuar efikasitetin e zbatimit të programit.
		4.5 Programi “Diaspora Vepron”: Remitancat dhe Sfidat e Investimeve						
		4.5.1 Një vlerësim vjetor i remitancave dhe politikave bankare nxitëse për Diasporën Shqiptare	2022	6,500	BSH	MSHD MFE	Përgatitja e Sfidës; zhvillimi i partneriteteve (sektori publik dhe privat) për të zbatuar sfidën;	Numri partnerëve të sektorëve publikë/privatë që do të zbatojnë sfidën.

							ngritja e panelit vlerësues për sfidën.	
		4.5.2 Zhvillimi dhe zbatimi i një politike koherente dhe gjithëpërfshirëse lidhur me menaxhimin e remitancave të Diasporës.	2020	950	MSHD	BSH MFE	Zhvillimi i platformës së investimeve; rishikimi i sfidës; shkallëzimi i programit (nëse është e aplikueshme); ndikimi në rritje i promovimit të eksportit; rritje e rrjetit të "lidhësve të tregut" për Shqipërinë; konkurrencë e rritur e tregtisë dhe investimeve shqiptare.	Zhvillimi i një platforme investimesh; zhvillimi i politikave gjithëpërfshirëse lidhur me menaxhimin e remitancave të Diasporës.
		4.5.3 Ndihmë për institucionet e mikrokreditit për zbatimin e politikave	2020	62,500	FSHZHD	Donator Institucio net Financiare BSH MFE	Angazhimi i institucioneve të mikrokreditit për të zbatuar politikat që synojnë në kanalizimin e remitancave nëpërmjet marrëveshjeve me institucionet financiare në vendet pritëse.	Numri i institucioneve të mikrokreditit të angazhuara për të zbatuar politikat për kanalizimin e remitancave; numri i marrëveshjeve me institucionet financiare në vendet pritëse.
		4.5.4 Krijimi i Bordit Qeverisës të Sfidës së programit "Diaspora Vepron"	2020	228	MSHD	Ministritë e linjës	Krijimi i Bordit Qeverisës për sfidën "Diaspora Vepron", që do të përfshijë përfaqësues të sektorëve publikë dhe privatë.	Numri i personave të ftuar që të jenë pjesë e bordit qeverisës; numri i personave nga sektorët publikë dhe privatë; numri i burrave dhe grave që marrin pjesë në bord.
		4.5.5 Përgatitja e Thirrjes për Sfidën: Mekanizmat Inovativë të Remitancave dhe Investimeve	2021	12,500	FSHZHD	MSHD MFE	Thirrja për Aplikime; Komunikimet/marketingu për sfidën.	Numri i Aplikantëve; numri i raporteve të mbuluara nga media; numri i statistikave të faqes së internetit.
		4.5.6 Gjetja e Donatorëve/Investitorëve/Sponsorëve për Sfidën	2021	190	FSHZHD	MSHD	Identifikimi i donatorëve/investitorëve dhe sponsorëve për sfidën.	Numri i donatorëve/investitorëve që marrin pjesë në sfidë.

		4.5.7 Turneu i Sfidës “Diaspora Vepron” (Mbajtur në Samitin apo Panairin Tregtar)	2021-2022	6,500	FSHZHD	MSHD MFE MTM MBZHR	Turneu i Sfidës “Diaspora Vepron” për të promovuar Panairin Tregtar në Shqipëri.	Numri i personave të informuar për turneun; numri i personave që marrin pjesë në turne; numri i bizneseve të pranishme.
		4.5.8 Shpallja e Fituesve	2022	304	MSHD	AKD	Një buletin/kanal komunikimi që do të shpallë fituesit bazuar mbi një sërë kriteresh.	Numri i personave të informuar për rezultatet e buletinit/kanalit të komunikimit.
		4.5.9 Sigurimi i Kapitalit të Farës për të zhvilluar projektet fituese	2022-2023	6,250	FSHZHD	MSHD MFE	Akordimi i Fituesit të Sfidës; dhënia e kapitalit të farës për fituesit.	Numri i projekteve që marrin kapitalin e farës; numri i burrave dhe grave të angazhuara; numri i qyteteve që përfitojnë.
		4.5.10 Raport Vlerësues për Sfidën	2023-2024	243	MSHD	GNIP	Raport i hollësishëm për programin; identifikimi i konsultimeve të brendshme dhe të jashtme për të ndihmuar me rishikimin; adresimi i sfidave dhe dhënia e listës së rekomandimeve.	Numri i rekomandimeve/mekanizma ve të identifikuar për të përmirësuar efikasitetin e zbatimit të programit.

Objektivi Specifik D: Monitorimi dhe Vlerësimi

Treguesi/-it i/e Rezultatit/-eve: % e rritur mes anëtarëve të diasporës që demonstrojnë ndërgjegjësimin për të drejtat e tyre sociale, politike dhe rilidhjes me vendin e origjinës.

E1	Monitorimi & Vlerësimi	E1.1 Rishikimi afatmesëm	2019-2022	3,168	MSHD	AKD Të gjitha ministrinë e linjës	Identifikimi i konsulentëve të brendshëm e të jashtëm që do të ndihmojnë me rishikimin; bashkërendimi i kulturës administrative; numri i konsultimeve të zhvilluara; botimi i rishikimit dhe Planit të Veprimit të përmirësuar, në përputhje me realitetin e tregut në kohën e rishikimit.	Numri i konsulentëve të brendshëm e të jashtëm për të rishikuar dokumentin; raportet monitoruese të përgatitura për zbatimin e Strategjisë për Diasporën.
		E.1.2 Rishikimi i Strategjisë dhe Hartimi i Planit të Veprimit, 2025 - 2030	2024	4,889	MSHD	AKD Të gjitha ministrinë e linjës	Identifikimi i vlerësuesve/auditorëve të jashtëm; numri i konsultimeve të brendshme të zhvilluara; numri i konsultimeve publike të zhvilluara; botimi i Rishikimit të Strategjisë; lançimi i Planit të 2-të të Veprimit 2025 – 2030.	Numri i raporteve vjetore monitoruese të përgatitura për zbatimin e Strategjisë për Diasporën.

SHTOJCA II – LISTA E AKTIVITETEVE PËR ÇDO MASË QË PREJ STRATEGJISË SË PARË

HYRJE

Kjo shtojcë përbën një dokument të përgjithshëm të përgatitur për të ilustruar se si janë ristrukturuar në kornizën zbatuese të Planit të Veprimit të dokumentit të strategjisë së rishikuar, 72 masat e përfshira në Strategjinë fillestare Kombëtare të Diasporës dhe Planin e Veprimit. Ky dokument, po ashtu, paraqet një vlerësim lidhur me listën e masave sipas shtyllave të strategjisë. Ky vështrim i përgjithshëm përbën një bazë të dobishme për të perceptuar të ardhmen dhe për të paraqitur dokumente lidhur me Strategjinë e rishikuar Kombëtare të Diasporës dhe Planin e Veprimit, meqenëse ai artikulon në mënyrë të përmbledhur synimet kryesore dhe fokusin e dokumentit të strategjisë.

LISTA E AKTIVITETEVE SIPAS SHTYLLAVE TË STRATEGJISË



Figura 1 Vështrim i përgjithshëm i Listës së Shtyllave të strategjisë sipas numrit të masave

Një veprim qendror i procesit të rishikimit të strategjisë ishte edhe zhvillimi i një mekanizmi zbatues për t'i mundësuar Ministrisë së Shtetit për Diasporën dhe homologëve të saj rritjen e angazhimit të diasporës. Gjatë procesit të rishikimit të 72 masave ishte e rëndësishme të hartohesh një koherencë dhe kornizë përkatëse, të cilat siguronin një bazë për zbatimin në rritje të masave të përshkruara. Sipas Dokumentit të Strategjisë, kjo kornizë bazohet në 5 shtylla. Këto shtylla kanë një përcaktim vijues masash brenda për brenda aktiviteteve të identifikuar sipas shtyllave:

Shtylla	Numri i Masave
Shtylla 1 – Qeverisja dhe Menaxhimi i Njohurive	19
Shtylla 2 – Avancimi i Programit të të Drejtave Politike dhe Sociale të Diasporës	23
Shtylla 3 – Programi për Kapitalin e Diasporës, Lidhjet e tyre dhe Ruajtja e Kulturës shqiptare	13
Shtylla 4 – Përfshirja e Diasporës në Programin e Zhvillimit Ekonomiko-social të vendit	13
Shtylla 5 – Monitorimi dhe Vlerësimi	4

SHTYLLA 1 – PROGRAMI I QEVERISJES DHE MENAXHIMIT TË NJOHURIVE

Aktiviteti 1.1

Krijimi i një kulture të re administrative

- Përbëhet nga 6 masa
- M1, M2, M3, M4, M5, M12

Aktiviteti 1.2

Ndërtimi i partneriteteve me komunitetin e donatorëve

- Përbëhet nga 1 masë
- M8 (përfshin përjashtime brenda qasjes
operacionale)

Aktiviteti 1.3

Diplomacia për Diasporën

- Përbëhet nga 6 masa
- M7, M10, M17, M20, M26, M65

Aktiviteti 1.4

Qendër Hulumtimi dhe Trajnimi për Diasporën

- Përbëhet nga 6 masa
- M9, M13, M15, M16, M19, M22

1.1 Krijimi i një kulture të re administrative (2018 – 2024)

Masa (si Aktivitet/Rezultat)	Masa (si Tregues)
<p><i>Masa 1</i></p> <hr/> <p><i>Bërja funksionale e të gjitha institucioneve që parasheh ligji i ri në fushën e marrëdhënieve të shtetit me diasporën, të tilla si: Agjencia Kombëtare e Diasporës, Fondi i Zhvillimit të Diasporës dhe Qendra e Botimeve për Diasporën. Hartimi i një plani të detajuar për thithjen e fondeve që nevojiten për financimin e politikave dhe masave që gjenden në Strategjinë Kombëtare. Një ndarje e qartë e kompetencave mes strukturave që do të merren me çështjen e trajtimit të diasporës. ngritja e një njësie të specializuar për rishikimin e legjislacionit për diasporën, me synimin e ndërmarrjes së ndryshimeve të nevojshme ligjore.</i></p>	
	<p><i>Masa 2</i></p> <hr/> <p><i>Aprovimi i programit vjetor të Komitetit Shtetëror për Diasporën, (aktivitete që përfshijnë librat, arsimin, kulturën dhe biznesin), dhe në bashkëpunim me Parlamentin e Shqipërisë të bëhet vlerësimi i pjesëmarrjes dhe përfaqësimit në këto organe. Përgatitja e informacionit vlerësues për Komitetin Shtetëror për Diasporën, si dhe për Nënkomisionin Parlamentar për Diasporën dhe Migracionin.</i></p>

	<p><i>Masa 3</i></p> <hr/> <p><i>Ndjekja e procedurave të nevojshme koordinuese që do të diskutohen çdo vit në Komitetin Shtetëror për Diasporën dhe caktimi i një buxheti vjetor (pasues) fondesh që nevojiten për të zbatuar Strategjinë Kombëtare për Diasporën dhe Planin e Veprimit deri më 2024.</i></p>
<p><i>Masa 4</i></p> <hr/> <p><i>Ngritja e Grupit të Punës për përgatitjen dhe organizimin e Samitit të Diasporës, si ngjarja më e rëndësishme për komunitetet shqiptare jashtë vendit. Organizimi periodik i Samitit të Diasporës, me qëllim që të rishikohen politikat aktuale për mobilizimin e diasporës shqiptare, aty ku duhen marrë në konsideratë çështje të tilla, si: ruajtja e gjuhës dhe kulturës, fenomeni i ikjes së trurit nga vendi dhe çështja e investimeve në Shqipëri.</i></p>	
<p><i>Masa 5</i></p> <hr/> <p><i>Ngritja e Këshillit Koordinues për Diasporën, si struktura koordinuese për fuqizimin organizativ të komuniteteve shqiptare me qëllimin e angazhimit dhe partneritetit në zhvillimin e Shqipërisë.</i></p>	
<p><i>Masa 12</i></p> <hr/> <p><i>Vlerësimi i qasjes së strategjive të tjera ekzistuese kombëtare ose i atyre strategjive të tjera që do të miratohen me Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit për Diasporën. Ky proces do të çojë edhe në organizimin e politikave ekzistuese publike, ose të atyre politikave që do të miratohen në të ardhmen e që kanë lidhje me politikat për komunitetet shqiptare jashtë vendit.</i></p>	

1.2 Ndërtimi i partneriteteve me komunitetin e donatorëve (2019 – 2024)

Masa (si Aktivitet/Rezultat)	Masa (si Tregues)
<p>Masa 8 _____</p> <p><i>Sigurimi i bashkëpunimit me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare për zbatimin e programeve që kanë këtë qëllim (për shembull, me PNUD-in, për zbatimin e programit TOKTEN në Shqipëri).</i></p>	

1.3 Diplomacia për Diasporën (2019 – 2024)

Masa (si Aktivitet/Rezultat)	Masa (si Tregues)
<p>Masa 7 _____</p> <p><i>Hartimi i një Plani të përbashkët Veprimi me shtetin e Kosovës në fushën e marrëdhënieve të diasporës dhe vënia në veprim e tij me qëllimin e përmirësimit të marrëveshjeve ekzistuese mes dy vendeve në këtë fushë. Përgatitja dhe zbatimi i marrëveshjeve të nevojshme në fushën e diasporës me të gjitha vendet që konsiderohen të rëndësishme dhe "produktive" për diasporën shqiptare kudo në botë.</i></p>	
<p>Masa 10 _____</p> <p><i>Vlerësimi i një pranie të re përfaqësimi diplomatik apo konsullor në vendet me një numër të konsiderueshëm komunitetesh shqiptare, të cilat janë të një rëndësie të veçantë për fuqizimin e mëtejshëm të marrëdhënieve diplomatike dhe ekonomike me vendin pritës dhe vendin e origjinës. Orientimi i planit të punës të organit diplomatik dhe konsullor me një fokus të veçantë në marrëdhëniet me komunitetet shqiptare jashtë vendit.</i></p>	

<p><u>Masa 17</u></p> <p><i>Inkurajimi i bashkëpunimit shtetëror me institucionet e profilizuara të vendeve pritëse dhe adresimi i çështjeve të migracionit, të drejtave të grave e të drejtave të fëmijëve. Ngritja e komisioneve konsultative bilaterale të nivelit të lartë me vendet pritëse për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve të diasporës shqiptare dhe funksionimi periodik i tyre për këtë qëllim. Ndarja e informacioneve publike lidhur me performancën dhe zhvillimin e kësaj veprimtarie për publikun e interesuar.</i></p>	
	<p><u>Masa 20</u></p> <p><i>Vendosja e kontakteve të rregullta me Grupin Evropian të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale në Fushën e Migracionit (ERLAI), me qendër në Bruksel, me qëllimin e vlerësimit të mundësive për mbështetjen e politikave mbrojtëse të komuniteteve të diasporës në vendet pritëse të BE-së.</i></p>
<p><u>Masa 26</u></p> <p><i>Vlerësimi dhe inkurajimi i migracionit qarkullues mes Shqipërisë dhe vendeve pritëse të komuniteteve shqiptare në diasporë përmes masave preferenciale ose përmes negociimit të marrëveshjeve bilaterale (duke i dhënë prioritet Greqisë dhe Italisë).</i></p> <p><i>Ngritja e një zyre koordinuese dhe caktimi e një personi kontakti për vlerësimin dhe monitorimin e gjendjes së tregjeve të huaja të punës, dhe më pas, përcjellja e këtij informacioni institucioneve përgjegjëse.</i></p>	
<p><u>Masa 65</u></p> <p><i>Hartimi dhe miratimi i marrëveshjeve të përbashkëta me Kosovën, dhe i atyre marrëveshjeve të veçanta për të mbështetur mësimin e gjuhës dhe kulturës shqipe në diasporë.</i></p> <p><i>Rivlerësimi i kornizës ligjore lidhur me përgjegjësitë e shtetit shqiptar për mundësimin e mësimin të gjuhës shqipe për brezat e rinj në komunitetet shqiptare në diasporë.</i></p>	

1.4 Qendër Hulumtimi dhe Trajnimi për Diasporën (2020 – 2024)

Masa (si Aktivitet/Rezultat)	Masa (si Tregues)
<p><u>Masa 9</u></p> <p>Rivlerësimi i akteve ligjore ekzistuese në fushën e migracionit duke zgjeruar sferën e mbrojtjes së komuniteteve shqiptare jashtë vendit, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe duke synuar në harmonizimin e tyre me Acquis Communautaire.</p> <p>Kryerja e procedurave për përfundimin e ratifikimit të marrëveshjeve të instrumenteve ndërkombëtare, (nëse nuk janë zbatuar ende), si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Konventa Nr. 143 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës, “Për Punonjësit Migrantë”. • Ratifikimi i Konventës së Këshillit të Evropës, “Mbi Statusin Ligjor të Punonjësve Migrantë”. • Ratifikimi i Konventës së Kombeve të Bashkuara, “Mbi Mbrojtjen e të Drejtave të të gjithë Punonjësve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të tyre”. 	
<p><u>Masa 13</u></p> <p>Vlerësimi dhe zgjerimi i Regjistrit Kombëtar Civil me të dhëna për migrantët dhe rishikimi periodik i bazave ligjore për regjistrimin e migrantëve. Përcaktimi i përgjegjësive e të dhënave që duhen mbledhur, si dhe identifikimi dhe planifikimi i ngritjes së rrjetit dhe infrastrukturës së duhur.</p> <p>Organizimi i veprimtarive publike dhe me shoqërinë civile për qëllimin e sistemit të regjistrimit dhe votimit të shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit.</p>	
<p><u>Masa 15</u></p> <p>Përgatitja e informacionit për diasporën shqiptare, si dhe për zhvillimin e komuniteteve shqiptare jashtë vendit. Përgatitja e një raporti vjetor që do të reflektojë mbi të dhënat dhe do të vlerësojë vendet të cilave iu duhet dhënë më prioritet në politikat e diasporës.</p> <p>TREGUESIT: Përgatitja e informacionit dhe përgatitja e raportit vjetor për diasporën shqiptare.</p>	

<p><i>Masa 16</i> _____</p> <p><i>Kryerja e trajnimit të përgjithshëm dhe të veçantë në fushën e migracionit dhe përfshirja e tyre në programet e universiteteve shqiptare. Organizimi i trajnimeve periodike në fushën e legjislacionit vendor dhe atij ndërkombëtar për zyrtarët që trajtojnë çështjet e migracionit. Identifikimi i nevojave dhe ekspertëve që mund të kryejnë trajnimet ligjore. Zhvillimi i moduleve të trajnimit në këtë fushë dhe përfshirja e tyre në trajnimin për punonjësit civilë.</i></p>	
<p><i>Masa 19</i> _____</p> <p><i>Përgatitja e manualeve praktike që lidhen me çështjet e migracionit dhe vënia e tyre në dispozicion të zyrtarëve që trajtojnë aspektin praktik të zbatimit të legjislacionit për migracionin. Identifikimi i ligjeve/akteve nënligjore që zbatohen në praktikë nga çdo institucion që trajton çështje të caktuara që lidhen me diasporën dhe migracionin. Trajnimi dhe certifikimi i trupit diplomatik shqiptar lidhur me legjislacionin për migracionin dhe, në veçanti, mbi të drejtat e komuniteteve shqiptare në diasporë.</i></p>	
<p><i>Masa 22</i> _____</p> <p><i>Rivlerësimi periodik i politikave dhe procedurave të shërbimeve, si dhe tarifave përkatëse. Duke u bazuar në të dhënat që dërgojnë misionet diplomatike, ministria përgjegjëse për diasporën do të përgatisë një raport vjetor lidhur me situatën aktuale të migrantëve shqiptarë, me propozime për masa përkatëse në mënyrë që të përmirësohet asistenca për këta të fundit.</i></p>	

SHTYLLA 2 – AVANCIMI I PROGRAMIT TË TË DREJTAVE POLITIKE DHE SOCIALE TË DIASPORËS

Aktiviteti 2.1

Samiti i diasporës

- Sipas planit në vazhdim

Aktiviteti 2.2

Programi mbështetës për diasporën shqiptare

- Përbëhet nga 12 masa
- M6, M11, M14, M18, M21, M28, M40, M42, M43, M45, M56, M67

Aktiviteti 2.3

Iniciativa "Shqipëria bën Avokaci"

- Përbëhet nga 5 masa
- M23, M24, M25, M39, M44.

Aktiviteti 2.4

Portali për Komunikimin dhe Median për diasporën shqiptare

- Përbëhet nga 6 masa
- M49, M50, M51, M52, M53, M54

2.1 Samiti i diasporës (2019 – 2024)

Masa (si Aktivitet/Rezultat)	Masa (si Tregues)
SIPAS PLANIT NË VAZHDIM	

2.2 Programi mbështetës për diasporën shqiptare (2019 – 2024)

Masa (si Aktivitet/Rezultat)	Masa (si Tregues)
<p><u>Masa 6</u></p> <p><i>Vlerësimi i organizimit të komuniteteve shqiptare në diasporë dhe përgatitja e një plani të veçantë veprimi për të promovuar organizimin e këtyre komuniteteve në nivelin rajonal dhe shtetëror në vendet pritëse. Promovimi i idesë së zhvillimit të aktiviteteve që e promovojnë këtë lloj organizimi nëpërmjet informimit të komunitetit shqiptar dhe identifikimit të burimeve njerëzore.</i></p>	
<p><u>Masa 11</u></p> <p><i>Promovimi i ndërgjegjësimit dhe orientimit të shtetasve shqiptarë jashtë vendit për përdorimin e shërbimeve konsullore dhe diplomatike që sigurohen nga misionet diplomatike shqiptare përmes platformës konsullore online. Dhënia e informacionit për organizatat jo-qeveritare të akredituara në vendin pritës, të cilat sigurojnë ndihmesë ligjore dhe mbrojtje për komunitetet e huaja.</i></p>	
<p><u>Masa 14</u></p> <p><i>Ngritja e Qendrave Shqiptare të Kulturës në vendet pritëse të diasporës, në bashkëpunim me shtetin e Kosovës, me qëllimin e ruajtjes së identitetit kombëtar, promovimit të imazhit të vendlindjes dhe shqiptarëve jashtë vendit, dhe sigurimi i shërbimeve dhe informacioneve për komunitetet shqiptare në diasporë.</i></p>	
<p><u>Masa 18</u></p> <p><i>Përgatitja dhe shpërndarja e informacionit (broshurave, fletë-palosjeve, portaleve të internetit, etj...) për komunitetet shqiptare në diasporë, aty ku informacioni për statusin dhe të drejtat e tyre sigurohet, si dhe për</i></p>	

<p><i>shërbimet që sigurohen nga misionet diplomatike dhe konsullore, e po ashtu, edhe për informacionet që sigurohen nga shoqatat e migrantëve me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare.</i></p>	
<p><i>Masa 21 _____</i></p> <p><i>Inkurajimi dhe intensifikimi i kontakteve të ngushta mes organizatave shqiptare në diasporë dhe shoqatave lokale për mbrojtjen e migrantëve. Identifikimi i organizatave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe migrantëve në vendet pritëse.</i></p> <p><i>Ndërgjegjësimi përmes informacionit online, tryezave të rrumbullakëta dhe takimeve lidhur me mbrojtjen sociale dhe shëndetësore në vendet pritëse dhe në vendlindjet e tyre.</i></p>	
<p><i>Masa 28</i></p> <p><i>Përgatitja e Certifikatës së Diasporës, për të cilën mund të aplikohet on-line bashkë me regjistrimin e personave të interesuar. Kjo i jep personit në fjalë një dokument të printuar që titullohet ("Unë jam shqiptar"), që mund të vendoset edhe nëpër vende të hapura për të përforcuar identitetin kombëtar shqiptar.</i></p>	
<p><i>Masa 40 _____</i></p> <p><i>Identifikimi i shoqatave kulturore, sportive, arsimore, shoqërore, shkencore që veprojnë në vendet pritëse, si dhe identifikimi i individëve të talentuar e të suksesshëm që punojnë në diasporë. Themelimi i një regjistri të veçantë për këtë qëllim.</i></p>	
	<p><i>Masa 42 _____</i></p> <p><i>Organizimi dhe mbështetja e rrjeteve (edhe në nivel ndërkombëtar) të grupeve të veçanta dhe shoqatave shqiptare në diasporë, duke u bazuar në interesat, profesionet e përbashkëta apo vendndodhjen gjeografike.</i></p> <p><i>Ndërmjetësimi me qëllim të vendosjes së kontakteve mes grupeve "partnere" në vende të ndryshme, për të krijuar një rrjet funksional të kësaj natyre, do të mbetet një prioritet i veçantë.</i></p>

	<p><i>Masa 43</i>_____</p> <p><i>Mbështetja e organizatave të diasporës shqiptare për të ngritur strukturat mbështetëse vendore për shtetasit e huaj në qytetet ku janë përqendruar migrantët shqiptarë, mbi bazën e një udhëzimi të përgatitur nga Kongresi i Autoriteteve Evropiane Lokale dhe Rajonale dhe Këshillit të Evropës.</i></p>
<p><i>Masa 45</i>_____</p> <p><i>Koordinimi dhe organizimi i takimeve apo i veprimtarive “Ditët për Shqipërinë” në vendet pritëse të komuniteteve shqiptare të diasporës mbi bazën e një programi vjetor, si dhe veprimtarive të tjera periodike për turizmin shqiptar dhe lehtësimet lidhur me investimet në Shqipëri.</i></p>	
	<p><i>Masa 56</i>_____</p> <p><i>Përfshirja e komunitetit shqiptar të diasporës në jetën kulturore të vendit pritës dhe në Shqipëri, me qëllimin e promovimit të tyre (nënshkrimi dhe/apo përmirësimi i marrëveshjeve bilaterale me vendet pritëse të diasporës, duke përfshirë këtu edhe interesat e këtyre të fundit), dhe promovimi i përcaktimit të veprimtarive vjetore për këtë qëllim.</i></p>
<p><i>Masa 67</i>_____</p> <p><i>Përgatitja e një raporti vlerësues mbi vështirësitë e studentëve shqiptarë që studiojnë jashtë vendit dhe faktorëve që ndikojnë në këtë situatë. Organizimi në vendet pritëse lidhur me marrjen e masave për të mundësuar komunikimin dhe funksionimin e rrjeteve për të ndihmuar studentët shqiptarë.</i></p>	

2.3 Iniciativa “Shqipëria bën avokaci” (2019 – 2024)

Masa (si Aktivitet/Rezultat)	Masa (si Tregues)
<p><i>Masa 23</i></p> <p>Do të zhvillohen negociata lidhur me nënshkrimin e marrëveshjeve bilaterale në fushën e mbrojtjes sociale të migrantëve me vendet pritëse, me qëllim që ata t’i transferojnë sigurimet shoqërore në Shqipëri. Po ashtu, do të bëhet rivlerësimi i marrëveshjeve akumuluese për kontributet vullnetare për sigurimet shoqërore, dhe aty ku do të jetë e nevojshme do të ketë edhe marrëveshje të nënshkuara mes Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe bankave, (Rivlerësimi i një plani të veçantë veprimi për çështjen e pensioneve të migrantëve shqiptarë).</p>	
<p><i>Masa 24</i></p> <p>Përgatitja e një regjistri për shtetasit shqiptarë të privuar nga liria dhe që gjenden nëpër burgje jashtë vendit, dhe organizimi i një takimi vjetor në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, Zyrën e Ombudspersonit dhe organizatën e Kryqit të Kuq Shqiptar për këtë çështje. Vlerësimi i informacionit dhe konkluzioneve periodike mbi këtë çështje do të diskutohen, po ashtu, edhe në Komitetin Shtetëror për Diasporën.</p>	
	<p><i>Masa 25</i></p> <p>Rishikimi i kornizës së marrëveshjeve ekzistuese të migracionit me vendet pritëse të komuniteteve shqiptare në diasporë. Negociimi i kornizës së marrëveshjeve të punësimit me vendet pritëse për qëllimin e përfshirjes në këto të fundit të marrëveshjeve për trajnime profesionale, ose për t’i diskutuar ato veçmas.</p> <p>Rivlerësimi do të bëhet në bashkëpunim me vendet e BE-së, si dhe me anë të projekteve të veçanta, për të lehtësuar zbatimin e marrëveshjeve të punësimit, përfitimit nga legjislati i përkohshëm apo i veçantë i vendeve pritëse që kanë mangësi në krahë pune.</p>

	<p><u>Masa 39</u></p> <p><i>Rivlerësimi për përmirësimin dhe zgjerimin e shërbimeve bankare në vendet pritëse të diasporës, si dhe për të afërmit e tyre në Shqipëri (kryesisht në zonat rurale). Inkurajimi i bankave në vendet pritëse të sigurojnë shërbime “ad hoc” për migrantët (brenda masës së mundësisë dhe negociimit) me ndihmën e shoqatave shqiptare të migracionit.</i></p>
<p><u>Masa 44</u></p> <p><i>Kryerja e fushatave të rritjes së ndërgjegjësimit lidhur me mundësitë e ndryshme të ankimimit ndaj shkeljeve të të drejtave të migrantëve, në strukturat lokale dhe ndërkombëtare të vendeve pritëse, që merren me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut, si dhe me mbrojtjen e të drejtave të migrantëve, përmes veprimtarive, të tilla si:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Botimit të këtij informacioni në portalet e migrantëve që i dedikohen kësaj çështjeje,</i> • <i>Botimi në gazetatat shqiptare jashtë vendit,</i> • <i>Botimi dhe shpërndarja e fletë-palosjeve që lidhen me këtë informacion,</i> • <i>Botimi i ketyre të drejtave përmes portaleve të krijuara nga komuniteti shqiptar që jeton jashtë vendit.</i> <p><i>Raportimi periodik në qeverinë shqiptare të rasteve të shkeljes së të drejtave të migrantëve shqiptarë. Disa prej strukturave ndërkombëtare që merren me këto të drejta janë si më poshtë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Raportuesi Special për të Drejtat e Migrantëve në Kombet e Bashkuara</i> • <i>Komisioneri për të Drejtat e Njeriut në Këshillin e Evropës</i> • <i>Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut</i> • <i>Komiteti Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) në Këshillin e Evropës</i> 	

- Komiteti për Peticione drejtuar Parlamentit Evropian për BE-në
- Ombudpersoni për BE-në

2.4 Portali për komunikimin dhe median për diasporën shqiptare (2020 – 2024)

Masa (si Aktivitet/Rezultat)	Masa (si Tregues)
<p>Masa 49</p> <p><i>Themelimi dhe përditësimi i një baze të dhënash për gazetatat, portalet, radiot dhe televizionet e diasporës që funksionojnë në vende që konsiderohen si parësore për politikën kombëtare për diasporën. Në këtë kornizë, themelimi i rrjeteve të radios dhe televizionit shqiptar në diasporë dhe zbatimi i një plani veprimi për trajnimin e gazetarëve në diasporë me projekte nxitëse dhe veprimtari vjetore për këtë qëllim.</i></p>	
<p>Masa 50</p> <p><i>Organizimi i një rrjeti informacioni për mediat shqiptare dhe të huaja për të ankimuar dhe ndërgjegjësuar shkeljen e të drejtave të migrantëve shqiptarë në strukturat përkatëse të vendeve pritëse, si dhe në organizatat ndërkombëtare.</i></p>	
<p>Masa 51</p> <p><i>Vlerësimi i cilësisë së portaleve të institucioneve shtetërore për informacione të detajuara lidhur me komunitetet shqiptare jashtë vendit, duke hapur një seksion që i dedikohet kësaj çështjeje, (aty ku është e nevojshme). Zhvillimi i takimeve periodike, (çdo 6 muaj), për të vlerësuar dhe koordinuar informacionin e portaleve të institucioneve me “përgjegjësit” lidhur me informacionin që japin këto portale për diasporën shqiptare.</i></p>	

Masa 52 _____

Planifikimi dhe zbatimi i një fushate informimi për:

- Migracionin dhe çështjet e diasporës;
- Promovimi në masë të madhe i regjistrimit të emigrantëve lidhur me të drejtën e votimit, (pas miratimit);
- Identiteti i shqiptarëve, historisë shqiptare dhe kulturës shqiptare në diasporë;
- Ekzistenca e burimeve të informacionit për çështje që lidhen me migrantët dhe diasporën, dhe për çështje që lidhen me zhvillimet e fundit politike, shoqërore dhe ekonomike në vend;

Shprehja në këtë fushatë e procesit që diaspora dhe migracioni do të jenë një pjesë integrale e zhvillimit politik dhe ekonomik të Shqipërisë.

Masa 53 _____

Rishikimi dhe vlerësimi zonës së transmetimit të radiove dhe televizioneve kombëtare në të gjithë vendet ku janë komunitetet e diasporës dhe migrantët shqiptarë. Gjenerimi dhe promovimi i programeve televizive në vend për çështjet e diasporës dhe rolit të saj në shoqërinë shqiptare. Realizimi dhe strukturimi i një kanali televiziv (dhe radiofonik) publik me temën e diasporës.

Inkurajimi i marrëveshjeve mediatike me vendet pritëse për të transmetuar programe për komunitetet shqiptare.

Masa 54 _____

Gjenerimi i projekteve mediatike që promovojnë ngritjen e rrjeteve të informacionit për studentët dhe koordinimi i institucioneve arsimore përgjegjëse për promovimin e programeve të shkëmbimit dhe praktikës (internship) të universiteteve shqiptare me vendet pritëse, aty ku ka një prani të madhe të studentëve shqiptarë.

SHTYLLA 3 – PROGRAMI PËR KAPITALIN E DIASPORËS, LIDHJET E TYRE DHE RUAJTJEN E KULTURËS SHQIPTARE

Aktiviteti 3.1

Programi "Fellows and Scholars" për Diasporën shqiptare

- Sipas planifikimit të IOM-it dhe 5 masave shtesë
- M30, M32, M64, M66, M68.

Aktiviteti 3.2

Cmimi "Ambasador i Kombit"

- Përbëhet nga 1 masë
- M31

Aktiviteti 3.3

"Ngrije zërin Shqipëri"

- Përbëhet nga 6 masa
- M58, M59, M60, M61, M62, M63

Aktiviteti 3.4

Rrjeti i Grave Shqiptare të Diasporës

- Përbëhet nga 1 masë
- M41

Aktiviteti 3.5

Java Kulturore e Diasporës

- N/A nuk ka masa si koncept i ri

3.1 Programi “Fellows and Scholars” për Diasporën (2019 – 2024)

Masa (si Aktivitet/Rezultat)	Masa (si Tregues)
KOMPONENTI FELLOWSHIP SIPAS PROJEKTIT TË IOM-it DHE MASA SHITESË:	
<p><i>Masa 30 _____</i></p> <p><i>Organizimi dhe administrimi i një rrjeti për shkollarët e huaj dhe shqiptarë në fushën e migracionit, si dhe të zyrtarëve të administratës të specializuar në institucionet që merren me politikën për diasporën dhe migracionin, (Mbushja e rrjetit me emra dhe detaje të shkollarëve dhe nëpunësve civilë nga agjencitë administrative që do të trajtojnë politikën e diasporës).</i></p>	
	<p><i>Masa 32 _____</i></p> <p><i>Krijimi i një baze të dhënash me personelin e kualifikuar të diasporës dhe zbatimi i programeve të përbashkëta me institucionet ndërkombëtare, me qëllimin e tërheqjes së anëtarëve të kualifikuar të diasporës për t’i shërbyer ekonomisë së Shqipërisë. Vlerësimi i programeve që inkurajojnë investitorët për të marrë në punë personel të kualifikuar nga diaspora jashtë vendit. Bazuar në këto programe, koordinimi dhe krijimi i mundësive për studentët shqiptarë në mënyrë që të mirëprehen e të ndihmohen nga anëtarë të diasporës shqiptare për të lehtësuar studimet e tyre nëpër universitete të huaja përmes një rrjeti të ngritur për këtë qëllim në diasporë.</i></p>
	<p><i>Masa 64 _____</i></p> <p><i>Rishikimi dhe drejtimi i programeve/donatorëve që japin bursa studimi jashtë vendit për ato fusha ekspertize që ka nevojë Shqipëria. Vlerësimi i performancës së një studimi të thellë mbi numrin e studentëve shqiptarë në universitetet jashtë vendit dhe në fushat në të cilat po specializohen ata. Rivlerësimi i përfshirjes së një kërkesë për kthim në Shqipëri, (për një periudhë kohore jo më pak se një vit), për të gjithë studentët që kanë fituar bursa studimi jashtë vendit brenda kornizës së programeve të ndryshme donatore për Shqipërinë.</i></p>

<p><u>Masa 66</u></p> <p><i>Promovimi i programeve apo donatorëve të cilët ofrojnë bursa studimi jashtë vendit për studentët, për Shqipërinë. Kryerja e aktiviteteve informuese për shkollat e mesme dhe universitetet duke synuar ndërgjegjësimin e profesorëve dhe studentëve për këto programe dhe procedurave të aplikimit.</i></p>	
<p><u>Masa 68</u></p> <p><i>Rivlerësimi i politikave që synojnë promovimin e migrantëve të aftë. Vlerësimi i kërkesës dhe ofertës në tregun shqiptar të punës për personelin e kualifikuar dhe krijimi i kontakteve mes migrantëve dhe ndërmarrjeve të mëdha e mesatare në Shqipëri, përmes krijimit të një baze elektronike të dhënash me CV-të e migrantëve më të kualifikuar.</i></p>	

3.2 Çmimi “Ambasador Shqiptar i Kombit” (2018 – 2024)

Masa (si Aktivitet/Rezultat)	Masa (si Tregues)
<p><u>Masa 31</u></p> <p><i>Promovimi i rasteve të personaliteteve të suksesshme ose në diasporë ose në Shqipëri dhe dhënia e çmimit “Ambasador i Kombit”. Krijimi i Rrjetit të Ambasadorëve të Kombit, (formulimi i akteve të nevojshme ligjore për këtë çështje).</i></p>	

3.3 “Ngrije zërin Shqipëri”(2020 – 2024)

Masa (si Aktivitet/Rezultat)	Masa (si Tregues)
	<p><i>Masa 58</i> _____</p> <p><i>Rishikimi i praktikave dhe kushteve për arsimin e brezit të ri në diasporë në gjuhën e tyre amtare. Identifikimi i nevojave për kurse të gjuhës shqipe në vendet pritëse. Rishikimi dhe hartimi i kurrikulës standarde për mësimdhënien në gjuhën shqipe.</i></p> <p><i>Identifikimi në vijim i nevojave të të nxëniet në gjuhën shqipe dhe njohurive të trashëgimisë kulturore shqiptare për fëmijët e diasporës.</i></p>
<p><i>Masa 59</i> _____</p> <p><i>Vlerësimi vjetor i nevojave për mësimin e gjuhës shqipe dhe njohjes së trashëgimisë kulturore shqiptare për fëmijët e diasporës. Përmirësimi periodik i kurrikulës së përbashkët me Kosovën për mësimin e gjuhës shqipe. Mbështetja e zbatimit të kurrikulës së përbashkët.</i></p>	
<p><i>Masa 60</i> _____</p> <p><i>Përgatitja e një Regjistri të mësuesve të diasporës dhe gjenerimi i programeve mbështetëse për zbatimin e standardeve për mësuesit e diasporës. Identifikimi i përhershëm i mësuesve dhe hartimi i një skeme pensioni për mësuesit e diasporës. Promovimi i veprimtarive arsimore me mësues shqiptarë dhe studentët të diasporës.</i></p>	
<p><i>Masa 61</i> _____</p> <p><i>Ngritja e një strukture të përhershme që do të bëjë vlerësimin dhe sigurimin e librave të nevojshëm shkollorë. Kjo strukturë do të ndjekë edhe trajnimin e mësuesve që do të japin mësim nëpër kurse dhe do të ngrihet për këtë qëllim. Sigurimi i vazhdueshëm i teksteve shkollore për diasporën dhe trajnimi i mësuesve për kurrikulën e përbashkët me Kosovën.</i></p>	

	<p><u>Masa 62</u></p> <p>Zhvillimi i projektit të e-librit, (shkarkimit on-line të librave shkollorë të përcaktuar në programin arsimor të diasporës), me qëllimin e shpërndarjes së librave në të gjithë botën dhe krijimin e lehtësimit për të furnizuar çdokënd me materialet e nevojshme për mësimin e gjuhës dhe kulturës shqipe.</p>
	<p><u>Masa 63</u></p> <p>Rishikimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve bashkëpunuese me institucionet arsimore të vendeve pritëse për hapjen e kurseve të gjuhës shqipe në shkollat ekzistuese dhe institucionet arsimore të vendeve pritëse; (gjenerimi dhe promovimi i programeve të mësimdhënies së gjuhës shqipe për fëmijët e emigrantëve shqiptarë në bashkëpunim me strukturat përkatëse të vendeve pritëse).</p> <p>Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet arsimore në vendet pritëse për hapjen e kurseve të gjuhës shqipe në shkolla dhe institucione ekzistuese në këto vende.</p>

3.4 Rrjeti i Grave Shqiptare të Diasporës (2020 – 2024)

Masa (si Aktivitet/Rezultat)	Masa (si Tregues)
<p><u>Masa 41</u></p> <p>Promovimi i Rrjetit të Grave të Diasporës dhe ngritja e politikave të veçanta lidhur më të. Organizimi në Shqipëri dhe jashtë saj i Samitit të Grave të Diasporës. Themelimi, për këtë qëllim, i një rrjeti të qëndrueshëm bashkëpunimi me organizata dhe institucione që mbulojnë këtë fushë në vendet pritëse dhe më shoqërinë civile në Shqipëri.</p>	

AKTIVITETI 3.5 JAVA KULTURORE E DIASPORËS (2021 – 2024)

Ky është një rekomandim i ri krahas masave ekzistuese.

SHTYLLA 4 – PËRFSHIRJA E DIASPORËS SHQIPTARE NË ZHVILLIMIN EKONOMIKO-SOCIAL TË VENDIT

Aktiviteti 4.1

Programi "Connect Albania"

- Sipas planit në vazhdim

Aktiviteti 4.2

Rrjeti Global i Profesionistëve Shqiptarë

- Të dhënat e mbledhura të kultivuara në aktivitete të tjera dhe formalizimi në rrjetin funksional

Aktiviteti 4.3

Programi "Me origjinë shqiptare"

- Përbëhet nga 9 masa
- M27, M33, M34, M35, M46, M47, M48, M55, M57

Aktiviteti 4.4

Programi "Diaspora vepron" : Remitancat dhe sfidat e investimeve

- Përbëhet nga 4 masa
- M29, M36, M37, M38.

4.1 Programi "Connect Albania" (2018 – 2024)

Masa (si Aktivitet/Rezultat)	Masa (si Tregues)
SIPAS PROJEKTIT TË IOM-it	

4.2 Rrjeti Global i Profesionistëve Shqiptarë (2020 – 2024)

Masa (si Aktivitet/Rezultat)	Masa (si Tregues)
<p>Bazuar në të dhënat e mbledhura nga aktivitetet e tjera dhe masave shtesë:</p>	
	<p><i>Masa 33 _____</i></p> <p><i>Krijimi i Dhomës së Biznesit të Diasporës në bashkëpunim me rrjetin e biznesit të diasporës. Krijimi i Regjistrimit të Biznesit të Diasporës, si një bazë për krijimin e Dhomës së Biznesit të Diasporës, si një organ organizativ dhe lehtësues në marrëdhëniet e biznesit me administratën shtetërore.</i></p>
<p><i>Masa 47 _____</i></p> <p><i>Organizimi periodik i takimeve me rrjetet e biznesit të diasporës dhe shkëmbimi i të dhënave funksionale me ta nga çdo institucion që mbulon fushën e interesit për investime në vendlindje.</i></p>	
	<p><i>Masa 48 _____</i></p> <p><i>MEPJ-ja përmes strukturave të saj të diplomacisë ekonomike do t'i kushtojë vëmendje të veçantë marrëdhënieve me diasporën shqiptare në fushën e shfrytëzimit të potencialit ekonomik që diaspora e ka vetë, duke i shërbyer kështu zhvillimit ekonomik dhe social të vendit. Bashkëpunimi me sektorin e biznesit privat dhe institucionet e linjës për shpërndarjen e informacionit të karakterit ekonomik dhe zhvillimin e pragramëve të veprimtarive vjetore periodike që mundësojnë marrëdhënie biznesi mes komuniteteve shqiptare në diasporë me njëri-tjetrin dhe me vendlindjen.</i></p>

4.3 Programi “Me Origjinë shqiptare” (2020 – 2024)

Masa (si Aktivitet/Rezultat)	Masa (si Tregues)
<p><u>Masa 27</u></p> <p><i>Organizimi i një programi vjetor të veçantë për promovimin e bujqësisë dhe prodhimeve ushqimore shqiptare, me anë të organizimit periodik të aktiviteteve në funksion të rrjeteve të organizuara të prodhuesve shqiptarë dhe rrjeteve të bizneseve shqiptare në diasporë që tregtojnë prodhime të kësaj natyre.</i></p>	
<p><u>Masa 34</u></p> <p><i>Zhvillimi i aktiviteteve vjetore në fushën e prodhimeve vendase në bashkëpunim me bizneset blerëse të diasporës, (krijimi i një harte restorantesh dhe biznesesh ushqimi të diasporës), për të lidhur bizneset e shitjes e të blerjes brenda dhe jashtë vendit.</i></p>	
	<p><u>Masa 35</u></p> <p><i>Rivlerësimi i festave kombëtare, fetare dhe pushimeve përmes një planifikimi të kujdesshëm të aktiviteteve, në bashkëpunim me sektorin privat, organizatat jo-fitimprurëse, federatat e sporteve dhe promovimin e tregjeve të rëndësishme me anë të institucioneve të turizmit, me qëllim që të rritet fluksi i turistëve.</i></p>
<p><u>Masa 46</u></p> <p><i>Koordinimi me institucionet publike dhe private të shëndetit lidhur me përgatitjen e fushatës për promovimin e turizmit shëndetësor, që lidhet kryesisht me disa shërbime për të cilat Shqipëria ka përparësi, (shërbimi dentar, neurokirurgjia, kardiokirurgjia, etj ...).</i></p>	

Masa 55

Krijimi i një plani veprimi mediatik për promovimin, tërheqjen dhe motivimin e diasporës shqiptare për të siguruar shfrytëzimin e gjithë potencialit të saj, si dhe shfrytëzimin e gjithë përparësive në Shqipëri për qëllimet e turizmit dhe investimeve. Do të bëhet vlerësimi i përgatitjes së një fushate promovimi nga ana e institucioneve përgjegjëse për turizmin, me qëllim që të tërhiqet vëmendja e atij sektori të diasporës që po kërkon mbi rrënjët, kulturën dhe traditat e paraardhësve. Në bashkëpunim me sektorin privat do të përgatitet një paketë që paraqet të gjitha pritshmëritë e mësipërme dhe, në raste të veçanta, e bën edhe prezantimin në gjuhën shqipe. Si figura të shquara të kësaj fushate, mund të përfshihen figura të mirënjohura të diasporës për secilin treg.

Masa 57

Krijimi i mjeteve administrative në nivelin qendror dhe vendor për asistencë dhe transparencë, për të mbështetur investimet dhe nevojat e partnerëve të interesuar të diasporës. Diaspora do të informohet lidhur me mundësitë e investimeve në Shqipëri nëpërmjet medias, bankave, (internetit, broshurave, etj ...), dhe do të promovohet motivimi i migrantëve shqiptarë për të investuar fitimet e tyre në sektorë të veçantë të ekonomisë.

4.4 Programi “Diaspora Vepron”: Remitancat dhe sfidat e investimeve (2020 – 2024)

Masa (si Aktivitet/Rezultat)	Masa (si Tregues)
	<p>Masa 29 _____</p> <p><i>Ndihmë për institucionet e mikrokredisë për të zbatuar politikat që synojnë kanalizimin e remitancave përmes marrëveshjeve me institucionet financiare në vendet pritëse.</i></p> <p><i>Inkurajimi i shoqatave të migrantëve për të promovuar zhvillimin vendor përmes mbledhjes vullnetare të donacioneve nga anëtarët, me qëllimin e përfitimit të granteve për projekte të ndryshme në qytetin apo fshatin e tyre.</i></p>
<p>Masa 36 _____</p> <p><i>Një vlerësim vjetor i remitancave dhe politikave nxitëse bankare për diasporën shqiptare. Zhvillimi dhe zbatimi i një politike koherente dhe gjithëpërfshirëse për menaxhimin e remitancave të diasporës. Rivlerësimi i masave që duhen ndërmarrë me qëllimin e rritjes së fluksit të remitancave përmes motivimit të migrantëve që i sjellin kursimet e tyre në Shqipëri, (si për shembull, përmes kurseve të favorshme të këmbimit, si dhe përmes mundësisë për t’i ruajtur ato në monedha të huaja).</i></p>	
